




Energy Regulatory Office
Zyra e Rregullatorit për Energji
Regulatorni Ured za Energiju

Rruga "Hamdi Mramori" Nr. 1 Prishtinë - Kosovë
Tel: +381 (0)38 247 615 lok. 101, Faks: +381 (0) 38 247 620 Email: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

RAPORTI VJETOR 2006



Prishtinë, Maj 2007

PARATHËNIA NGA KRYESUESI

Kam kënaqësinë t'ia paraqesë Kuvendit të Kosovës raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) që përfshin vitin fiskal 2006.

Ky është raporti i tretë me radhë që nxjerr ZRRE-ja. Si një agjension i pavarur ZRRE-ja rregullon dhe mbikëqyr funksionet operuese kyçe të ndërmarrjeve në Sektorin e energjisë siç janë: energjia elektrike, gazi dhe ngrohja qendrore.

Për vitin 2006 aktivitetet e ZRRE-së janë përkrahur nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, nga Shtylla IV e UNMIK-ut dhe ndërmarrjet energjetike të rregulluara përmes taksave dhe ngarkesave vjetore. Tani e tutje kostot operative në tërësi do të paguhen nga shfrytëzuesit dhe përfituesit e shërbimeve të ZRRE-së e jo nga taksapaguesit.

Nga donatorët janë financuar konsulenca të jashtme për të zhvilluar projekte të caktuara dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit.

Viti 2006 ka qenë vit i rëndësishëm për tregun e energjisë në Kosovë. Aktivitetet janë përsheptuar në të gjitha frontet për të krijuar kushte dhe mjedis të përshtatshëm për një treg të hapur e konkurrues të energjisë që do të joshë investitorë më të mirë për t'u të angazhuar në këtë sektor, në harmoni me direktivat e evropiane për energji dhe Marrëveshjen për komunitetin e energjisë në Evropën Juglindore që është nënshkruar edhe nga Kosova.

Gjatë vitit 2006 ka ndodhur shthurja e KEK-ut dhe krijimi i Operatorit të pavarur të sistemit të transmissioinit (KOSTT). Janë miratuar kodet e rrjetit dhe kodet e matjes dhe rregullat e përkohshme të tregut. Janë lëshuar 25 licenca për ndërmarrjet kombëtare dhe ndërkombëtare të energjisë, të cilat janë aktive në Sektorët e energjisë elektrike dhe ngrohjes qendrore në Kosovë. Një ndër aktivitetet më të rëndësishme ka qenë ndërmarrja e rishikimit të parë të çmimeve në Sektorin e energjisë elektrike në Kosovë, i cili ka thithur përpjekjet kryesore të ZRRE-së të pjesës më të madhe të vitit 2006, që ka rezultuar me disenjimin e tarifave të para të shthurura të energjisë elektrike në Kosovë.

Në po këtë vit Kosova ka shpallur tenderin ndërkombëtar për hapjen e minieres së re të linjtitit dhe ndertimin e kapacitet të ri gjenerues me fuqi deri në 2100 MW. Ky do të jetë njëri nga investimet më të reja për gjenerim në tërë rajonin e EJT, i cili ka filluar të përjetojë një situatë shumë të vështirë të furnizimit me energji elektrike.

Kam kënaqësinë të raportoj se në të gjitha këto zhvillime ZRRE-ja ka pasur rol të rëndësishëm përmes zhvillimit dhe miratimit të mekanizmave dhe kodeve për tregun e energjisë, duke bërë konsultime publike, monitorim të ndërmarrjeve të licencuara dhe miratimin e tarifave stimuluese për Sektorët e energjisë elektrike dhe të ngrohjes qendrore.

Në fillim të vitit 2007 është kryer kalimi përgjegjësive të ZRRE-së te vendorët duke përfunduar me sukses mandati kryesuesit të parë të ZRRE-së të përcaktuar me dispozitat e legjislacionit në fushën e energjisë.

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë kolegët e mi për përpjekjet dhe zotimin e tyre të palëkundur për kryerjen me sukses të përgjegjësive dhe obligimeve të tyre të mëdha. Me keqardhje dua të theksoj se në fillim të vitit 2007 ZRRE-ja ka humbur disa prej punonjësve më të mirë

profesionistë për shkak të disa keqkuptimeve lidhur me buxhetin dhe pagat. Përndryshe ZRRE-ja ka një buxhet të shëndetshëm i cili mundëson përmbushjen e planit të biznesit, andaj besoj që kjo vështirësi mund të adresohet dhe të tejkalohet në Kuvendin e Kosovës në mënyrë që ZRRE-ja të ketë mundësi që të angazhoj burime më të mira njerëzore.

ZRRE-ja punën e vet e mbështet në bashkëpunimin e mirë e të besueshëm me të gjitha palët e interesuara në Sektorin e energjisë: me konsumatorë, organizata, ndërmarrje dhe autoritete, dhe mbetet e përkushtuar për ta mbrojtur mirëqenien ekonomike të konsumatorëve të energjisë në Kosovë duke siguruar industri energjetike të shëndoshë, konkurruese dhe efikase.

Me respekt,

Dr. Ali Hamiti

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

PËRMBAJTJA

PARATHËNIA NGA KRYESUESI	1
PËRMBAJTJA.....	3
LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE	5
LISTA E SHKURTESAVE	7
KAPITULLI 1 RISHIKIM I ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E ENERGJISË GJATË VITIT 2006	9
1.1 Mihja e Linjtit.....	9
1.2 Prodhimi dhe konsumi i energjisë elektrike.....	10
1.3 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike	12
1.4 Humbjet joteknike të KEK-ut	13
1.5 Ristrukturimi i KEK-ut/Korporatizimi i KOSTT	14
KAPITULLI 2 ZHVILLIMET RREGULLATIVE GJATË VITIT 2006	17
2.1 Legjislacioni sekondar i miratuar në vitin 2006 dhe i paraparë për vitin 2007.....	17
2.2 Aktivitetet e licencimit	19
2.3 Kodet teknike/qeverisja e kodeve – mekanizmi përcaktues për kapacitetet e transmisionit ndërldhës.....	20
2.4 Rregullat e përkohshme të tregut.....	23
KAPITULLI 3 ZHVILLIMI I KAPACITETIT TË RI GJENERUES (ME LINJIT) DHE MINIERA SHOQËRUESE.....	27
3.1 Projekti i asistencës teknike për energji nga linjiti - PATEL.....	27
3.1.1 Historiku.....	27
3.1.2 Strategjia e Qeverisë.....	28
3.1.3 Situata aktuale e minierave dhe furnizimit me linjit.....	28
3.1.4 Përkrahja e donatorëve	30
3.1.5 Struktura menaxhuese e projektit për projektin ATEL	30
3.1.6 Objektivat e projektit PATEL dhe përmbledhja e komponenteve – implementimi.....	32
3.2 Shprehja e interesit (ShI) dhe lista e shkurtër e ofertuesve të kualifikuar (kriteret, lista).....	32
3.3 Fushëveprimi i këshilltarëve teknik.....	33
3.4 Studimet për përkrahjen e zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe transmisionit përkatës	35
KAPITULLI 4 SHQYRTIMI I PARË I ÇMIMEVE NË SEKTORIN E ENERGJISË (PËR PERIUDHËN RREGULLATIVE 2007-2009).....	37
4.1 Historiku.....	37
4.2 Parimet	38
4.3 Përmbledhja e procesit.....	40

4.3.1 Përcaktimi i të hyrave të lejuara	40
4.3.2 Miratimi i tarifave të rregulluara.....	41
4.3.3 Orari.....	41
4.3.4 Rezultatet.....	42
4.3.5 Burimet.....	43
KAPITULLI 5 MBROJTJA E KONSUMATORËVE	44
5.1 Numri dhe procesimi i ankesave	44
5.2 Raporti i monitorimit të KEK-ut	50
KAPITULLI 6 NGROHJA QENDRORE	53
6.1 Pasqyrë e zhvillimeve në Sektorin e ngrohjes qendrore në vitin 2006.....	53
6.2 Performansa e kompanive të ngrohjes qendrore.....	54
6.2.1 Konsumi i derivateve dhe gjenerimi i ngrohjes	54
6.2.2 Shpërndarja e ngrohjes	55
6.2.3 Çështje lidhur me konsumatorët	56
6.3 Shqyrtimi i çmimeve për ngrohje qendrore – sezoni 2006/2007.....	57
6.3.1 Korniza ligjore dhe rregullative për shqyrtimin e çmimit për ngrohje qendrore.....	57
6.3.2 Procesi i shqyrtimit të çmimeve.....	58
6.3.3.Përcjellja e implementimit të tarifave për sezonin 2006/2007	61
KAPITULLI 7 ZHVILLIMET RAJONALE DHE MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE	62
7.1 Komuniteti energjetik i EJL - ECRB.....	62
7.2 ShRRrE/FRrB/ShKKRrK.....	63
7.3 Konferencat dhe trajnimet e ZRRE-së.....	63
KAPITULLI 8 PASQYRA FINANCIARE 2006 - PLANI I BIZNESIT – PROJEKT DOKUMENTI.....	66
8.1 Raporti vjetor financiar i ZRrE-së për vitin 2006.....	66
8.2 Stafi i ZRrE-së	68
8.3 Të hyrat nga taksat e licencave	68
8.4 Plani i biznesit.....	68

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

- Tabela 1.1 Tabela më poshtme paraqet prodhimin dhe konsumin e linjitit në 2005/2006
- Figura 1.1 Prodhimi dhe konsumi i linjitit në 2005/2006
- Tabela 1.2. Në tabelën më poshtme janë paraqitur të dhënat e kapacitetit të njësive të prodhimit termal dhe hidrik.
- Tabela 1.3. Prodhimi i energjisë elektrike në krahasim me bilancin e vitit 2006.
- Figura 1.2. Prodhimi i energjisë elektrike për njësi dhe importet në MWh
- Tabela 1.4. Konsumi i energjisë elektrike në krahasim me bilancin e vitit 2006.
- Tabela 1.5 Importet, eksportet dhe shkëmbimi në vitin 2006
- Figura 1.3 a) importi i energjisë elektrike në 2006; b) çmimi i importit të energjisë elektrike 2006
- Tabela 1.6. Energjia e importuar gjatë periudhës 2000-2006; Figura 1.4 çmimet e energjisë prej vitit 2000-2006
- Figure 1.4 Çmimet e energjisë prej vitit 2000-2006
- Tabela 1.7 Humbjet e përgjithshme, humbjet teknike dhe joteknike.
- Figura 1.5 Humbjet e përgjithshme, humbjet teknike dhe joteknike.
- Figura 1.6 Struktura e shthurur e KEK-ut
- Figura 2.1. Tregu i energjisë elektrike
- Figura 2.2 Rrjedhat financiare
- Figura 3.1. Prodhimi i projektuar për të ardhmen nga miniera e Bardhit dhe Mirashit, Burimi: KEK, MEM
- Tabela 3.1 Burimi: kostoja e zhvillimit të Minierës “Sibovc JP”, Steag, Maj 2006
- Figura 3.2
- Figura 3.3
- Tabela 3.2. Afati kohor për implementimin e projektit
- Tabela 4.1: Të ardhurat e lejuara të miratuara
- Figura 4.1: Mesatarja e tarifave për ekonomitë familjare në Evropën Juglindore
- Tabela 5.1 Numri i ankesave të regjistruara në Departamentin për kujdes ndaj konsumatorëve të KEK-ut në vitin 2006
- Figura 5.1 Prezantimi grafik i ankesave të regjistruara në Departamentin për kujdes ndaj konsumatorëve të KEK-ut në vitin 2006
- Tabela 5.2 Numri i ankesave të zgjidhura nga Departamenti për kujdes ndaj konsumatorëve të KEK-ut në vitin 2006
- Figura 5.2 Prezantimi grafik i ankesave të zgjidhura nga Departamenti për Mbrojtjen e konsumatorëve të KEK-ut në vitin 2006
- Tabela 5.3 Ankesat e regjistruara nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007.
- Figura 5.3 Prezantimi grafik i ankesave të regjistruara nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007
- Tabela 5.4 Numri i ankesave të zgjidhura nga Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007.
- Figura 5.4 Prezantimi grafik i ankesave të zgjidhura nga Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007.
- Tabela 5.5 Krahasimi i ankesave të regjistruara dhe ankesave të zgjidhura nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, si dhe grafikoni për periudhën janar 2006 - mars 2007.

Figura 5.5 Prezantimi grafik i krahasimit të ankesave të regjistruara dhe ankesave të zgjidhura nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, dhe grafikoni për periudhën janar 2006 - mars 2007.

Tabela 6.1 Konsumi i derivateve dhe çmimi mesatar blerës për sezonën 2005/2006

Tabela 6.2 Karakteristikat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Tabela 6.3 Shkalla e arkëtimit në kompanitë e NQ-ve në Kosovë për sezonin 2005/2006

Tabela 6.4 Tarifat për kompanitë e ngrohjes Qendrore në Kosovë – sezoni 2006/2007

Tabela 8.1 Pasqyrë e burimeve financiare dhe shpenzimeve në €.

Tabela 8.2 Totali i shpenzimeve të ZRRE-së për vitin 2006:

LISTA E SHKURTESAVE

ARRER	Autoriteti Rregullativ për Energji në Romani
ARRMN	Agjencia e Republikës së Kazakistanit për Rregullimin e Monopoleve Natyrore
AKT	Alokimi i Kapaciteteve Transmetuese
PPRT	Projekti për Pastrimin dhe Rikuperimin e Tokës
DMK	Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve
TNK	Tregtim Ndërkufitar
KRREE	Këshilli i Rregullatorëve Evropian për Energji
ČEZ	Kompani e licencuar për tregtim/furnizim me energji elektrike (Kompani e Republikës Çeke)
NQ	Ngrohje Qendrore
KNQ	Kompani për Ngrohje Qendrore
NjNQ	Njësia e Ngrohjes Qendrore
ORRSh	Operator i Rrjetit të Shpërndarjes (Distribucionit)
OSSHD	Operator i Sistemit të Shpërndarjes Distribucionit
AER-i	Agjencia Evropiane për Rindërtim
KE	Komuniteti Energjetik
KEEJL	Komuniteti Energjetik në Evropën Juglindore
EFT	Energy Financing Team (Ekipi për Financimin e Energjisë)
EGL	Elektrizitats Gesellschaft Laufenburg
RREES	Rrjeti i Energjisë Elektrike në Serbi
SHI	Shprehje Interesi
KRRERM	Komisioni Rregullativ për Energji në Republikën e Maqedonisë
ERRSEE	Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (Shqipëri)
GRREEEG	Grupi i Rregullatorëve Evropian për Energji Elektrike dhe Gaz
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
ShRRRE	Shoqata Rajonale e Rregullatorëve për Energji
SFTE	Struktura e Furnizimit dhe Tregut të Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
ZÇF	Zyra për Çështje Fiskale
SIGH	Studim për Investime në Gjenerim
GWh	Giga Watt orë
HC	Hidrocentral
HSE	Holding Slovenske Elektrane
BNRZH	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
ANZH	Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim
KFN	Korporata Financiare Ndërkombëtare (Grupi i Bankës Botërore)
KNOST	Kompensimi ndërmjet OST-ve
OPSTT	Operator i Pavarur i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut
SH.A.	Shoqëri Aksionare
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KESH	Korporata Energjetike e Shqipërisë
KOSTT	Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut në Kosovë
AKM	Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit
KW	Kilovat
KWh	Kilovat orë
DÇLL	Departamenti për Çështje Ligjore dhe Licencim

PATEL	Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti
ATEL	Asistenca Teknike për Energji nga Linjiti
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AGIM	Agjencia Garantuuese për Investime Multilaterale
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OT	Operator Tregu
MW	Megavat
MWh	Megavat orë
ShKKRRK	Shoqata Kombëtare e Komisionarëve Rregullativ për Komunalitë
NA	Nuk Aplikohet
KQKO	Komisioni Qeverisës i Kodeve Operacionale
MO	Manual Operacioni
DVP	Dokumenti i Vlerësimit të Projektit
IPVQ-të	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
NPK	Ndërmarrje Publike Komunale
NP	Ndërmarrje Publike
KBEE	Kontratë për Blerje të Energjisë Elektrike
BRRA	Baza Rregullative për Asete
SIRB	Studimi për Infrastrukturën Rajonale të Ballkanit
NeK	Norma e Kthimit
KEJL	Konsumatori i Evropës Juglindore
EJL	Evropa Juglindore
RREEJL	Rregullatorët për Energji në Evropën Juglindore
SEETEC	Projekti i Përkrahjes Teknike për Sistemin e Energjisë Elektrike të Evropës Jugore
OSTEJL	Operatori i Sistemit të Transmisionit për Evropën Juglindore
OS	Operator Sistemi
S R O	Kompania e licencuar për tregtim/furnizim me energji elektrike EZPADA” (Kompani e Republikës Çeke)
JP	Jugperëndim
AT	Asistencë teknike
TF	Task Forca
SHST	Shfrytëzimi i Sistemit për Transmision
QPT	Qasja e Palës së Tretë
TC	Termocentral
OST	Operatori i Sistemit të Transmisionit
UKTEE	Unioni për Koordinimin e Transmisionit të Energjisë Elektrike
UNMIK	Misioni të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
MPKK	Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit
FRrB	Forumi Rregullativ Botëror

KAPITULLI 1

RISHIKIM I ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E ENERGJISË GJATË VITIT 2006

Padyshim që e arritura më e madhe në Sektorin e energjisë është shthurja dhe korporatizimi i Operatorit të Pavarur të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT, nga kompania e integruar në mënyrë vertikale - KEK-u.

Biznesi i KEK-ut aktualisht përfshinë: minierat e linjtit, gjenerimin e energjisë elektrike, distribuimin dhe furnizimin.

KOSTT-u i ka në pronësi të gjitha pasuritë për transmision dhe përgjegjësinë për operimin e sistemit dhe tregut (në harmoni të plotë me kërkesat e traktatit të KEEJL-it).

Me kushtet e vendosura në kodin e rrjetit, operatori i sistemit në pajtim me rregullat e tregut luan rol thelbësor në balancimin fizik. Megjithatë, OST-ja shfrytëzon këto rregulla komerciale për tregtimin e shërbimeve dhe në kapacitetin e agentit administron mekanizmat e balancimit në rastet kur anëtarët e tregut (të njohur si palë tregtare) tregtojnë energji balancuese. Roli kryesor i Operatorit të tregut është përgjegjësia për organizimin dhe administrimin e tregtimit të energjisë dhe shlyerjes financiare të pagesave për prodhuesit, furnizuesit dhe konsumatorët e privilegjuar. Operatori gjithashtu ka kapacitetin e “pronarit” të rregullave të tregut.

1.1 Mihja e Linjtit


Linjiti është burimi kryesor i energjisë në Kosovë. 98% e linjtit të nxjerrë i dedikohet prodhimit të energjisë elektrike në KEK, ndërsa energjia elektrike varet plotësisht nga furnizimi me linjit. Rezervat kryesore të linjtit gjenden në dy basene të mëdha të quajtura “Kosova” dhe “Dukagjini” me kualitet të mirë të rezervave të përdorura, me nivel të ulët të squfurit dhe nivel të mirë të koncentratit të gëlqerës. Rezervat e linjtit vlerësohen të jenë prej 11 deri 14 miliardë tonë. Aktualisht janë funksionale dy miniera sipërfaqësore (Bardh dhe Mirash) të cilat furnizojnë njësitë gjeneruese të energjisë elektrike në KEK me 6.5 milion ton linjit në vit. Vlerësimet përfundimtare tregojnë se rezervat në këto dy miniera do të shteren deri në vitin 2012 për shkak të rënies së nxjerrjes duke filluar nga viti 2009. Kjo çështje është alarmuese dhe ngritë nevojën për investime në minierë të re të linjtit e cila do të fillojë së funksionuari në vitin 2009.

Për minierën e re në Sibovc JP janë bërë studime të realizueshmërisë të cilat janë financuar nga AER-i.

Duke pasur parasysh një iniciativë të tillë nevojiten investime të larta, kështu që përpjekjet janë drejtuar në gjetjen e investitorit nga sektori privat.

Tabela 1.1 Tabela e poshtëshenuar paraqet prodhimin dhe konsumin e linjtit në 2005/2006

Prodhimi & Konsumi i Linjtit	Realizimi 2005	Bilanci 2006	Realizimi 2006	Realiz/Bilanc 2006	Përqindja 2006/2005
Gjithsej prodhimi i linjtit	6 536 759	7 100 000	6 532 355	92.01%	99.93%
Gjithsej konsumi i linjtit	5 796 658	6 415 047	5 830 253	90.88%	100.58%

Figura 1.1 Prodhimi dhe konsumi i linjitit në 2005/2006

1.2 Prodhimi dhe konsumi i energjisë elektrike

Sic është përmendur më lartë, prodhimi i energjisë elektrike në KEK plotësisht varet nga linjiti i cili përbën rreth 98% të prodhimit vjetor të energjisë elektrike. Pjesa tjetër e prodhimit mbulohet nga HC “Ujmani” dhe nga HC “Lumbardhi” dhe “Radavci”.

Tabela 1.2. Në tabelën më poshtë janë dhënë të dhënat e kapacitetit të njësive të prodhimit termal dhe hidrik.


Njesite prodhuese	Viti i lëshimit në punë	Kapaciteti i dizajnuar	Kapaciteti operativ	
			Gjenerator	Prag
A1	1962	65	35	32
A2	1964	125	-	-
A3	1970	200	135	120
A4	1971	200	135	120
A5	1975	210	115	110
TC Kososva A		800	420	382
B1	1983	339	290	265
B2	1984	339	280	260
TC Kososva B		678	570	525
Sh.A. Kosova Thengjilli	1970	25 + 16		
HC Ujmani	1981	2 * 17.5	35	35
Hc Lumbardhi	1957/2005	2 * 4.04	8.08	8.08

Totali i energjisë së prodhuar në vitin 2006 është 3996 GWh që është gati i barabartë me totalin e prodhuar në vitin 2005. Ky prodhim ka arritur 95% të bilancit të energjisë elektrike për vitin 2006, që ishte 4200 GWh.

Tabela 1.3. Prodhimi i energjisë elektrike në krahasim me bilancin e vitit 2006

Njesite	Realizimi 2005	Bilanci 2006	Realizimi 2006	Realiz/Bilanc 2006
A1	64 542	0	7,609	0.00%
A3	- 2 775	384,468	347,551	90.40%
A4	- 1 167	0	-1,046	0.00%
A5	584 350	310,704	544,416	175.22%
TC Kososva A	644 950	695,172	898,529	129.25%
B1	1 476 759	1,610,988	1,376,516	85.45%
B2	1 767 575	1,756,950	1,595,667	90.82%
TC Kososva B	3 244 334	3,367,938	2,972,182	88.25%
Sh.A. Kosova Thengjilli	778	25,000	0	0.00%
HC Ujmani	109 682	88,000	99,562	113.14%
Hc Distributive	0	24,354	26,624	109.32%
Total Prodhimi	3,999,744	4,200,464	3,996,897	95.15%
Marre (Imp+Shk)	490 632	685,600	536,238	78.21%
Dhenje (Eksp+Shk)	225 965	210,700	252,527	119.85%

Shënim: Vlerat negative për A3 dhe A4 janë për shkak të realizimit pasi që këto njësi kanë pasur shpenzime energjie për riparim

Figura 1.2. Prodhimi i energjisë elektrike për njësi dhe importet në MWh

Konsumi bruto është realizuar në vlerë prej 4281 GWh ose 92% të bilancit, ndërsa shpërndarja neto është realizuar në vlerë 2046 GWh ose 89% të bilancit. Konsumatorët e privilegjuar, të brendshëm dhe thëngjilli i Kosovës kanë shpenzuar 107 GWh që është 26% në krahasim me bilancin në vlerë prej 410 GWh. Kjo kryesisht ka ndodhur për shkak të mosrealizimit të planit të Ferronikelit për konsum të energjisë elektrike.

Konsumi i enegjisë është llogaritur të jetë realizuar sipas regjimit të reduktimit mesatar 5:1, duke përdorur metodën e klasifikimit ABC me një tendencë që konsumatorët e kategorisë A të furnizohen me energji 24 orë në ditë, kategorisë B - 5:1 dhe kategorisë C - 4:2, ose me pjesën e mbetur të energjisë elektrike. Ky plan në përgjithësi është realizuar, përveç në disa raste urgjente.

Konsumi i energjisë elektrike në krahasim me bilancin e vitit 2006.

Tabela 1.4. Konsumi i energjisë elektrike në krahasim me bilancin e vitit 2006

Lloji	Bilanci 2006	Realizimi 2006	Realiz/Bila nc 2006
	MWh	MWh	
Konsumi bruto	4,651,045	4,281,400	92.05%
Distribucioni neto	2,294,060	2,045,870	89.18%
Trepca	59,900	29,347	48.99%
Feronikeli	152,200	2,759	1.81%
Sharri	54,300	48,038	88.47%
Kons intern KEK	126,500	25,274	19.98%
WDG+Kosova Thengjilli	17,000	1,774	10.44%

1.3 Importi dhe eksporti i energjisë elektrike

Varësisht nga prodhimi i konsumi ditor dhe mujor, në bilancin e vitit 2006 është paraparë importimi i energjisë elektrike prej 685.6 GWh dhe eksportimi 210.7 GWh.

Realizimi i kontratave të importit dhe eksportit është bërë duke u bazuar në tenderët e publikuar nga KEK-u dhe miratuar nga ZRRE-ja, ndërsa shkëmbimet (marrjet dhe dhëniet) janë realizuar sipas kërkesave dhe mundësive. Kështu, importet e kontraktuara kanë qenë 393 GWh, ndërsa eksportet e kontraktuara 80 GWh, ndërkaq si shkëmbim janë importuar 143 GWh dhe eksportuar 172 GWh. Vlen të theksohet se ekziston një trend i rritjes së çmimit të importeve.

Totali i importeve (të kontraktuara + shkëmbimet) është 536 GWh ose 78% e bilancit për vitin 2006, ndërsa niveli i eksporteve ka arritur në 253 GWh ose 120% të bilancit. Më poshtë gjendet tabela dhe diagramet për importet, eksportet, dhe çmimet e importeve për muaj. Mesatarja e ponderuar e çmimit të importeve është 54.87€, ndërsa eksporteve 40.75€.

Importet, eksportet dhe shkëmbimi në vitin 2006


Tabela 1.5 Importet, eksportet dhe shkëmbimi në vitin 2006

Muaji	Bilanci 2006	Dhenje- shk.	Marrje- shk.	Eksport	Import	Çmimi
	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	€
1	-116,500	3,100	32,190	0	5,730	64.26 €
2	-112,300	3,300	3,080	0	63,352	52.19 €
3	-43,500	4,220	40,962	0	0	0.00 €
4	-24,000	12,858	37,297	0	27,280	51.56 €
5	-78,000	3,250	8,260	0	64,480	47.38 €
6	-37,700	12,898	4,230	0	42,432	52.58 €
7	100,400	36,356	0	67,864	7,200	38.90 €
8	110,300	25,650	9,905	12,308	18,460	45.06 €
9	-87,000	38,069	4,720	0	36,000	58.94 €
10	-36,500	14,968	1,000	0	64,182	59.84 €
11	-60,200	14,276	1,540	0	25,450	63.46 €
12	-89,900	3,410	0	0	38,488	65.20 €
Total	474,900	172,355	143,184	80,172	393,054	54.87 €

Shënim: Vlerat negative në shtyllën e bilanceve paraqesin importet ndërsa ato pozitive paraqesin eksportet

Diagramet e importit dhe shkëmbimit të energjisë me çmim të importit.


Figura 1.3 a) importi i energjisë elektrike në 2006; b) çmimi i importit të energjisë elektrike 2006



Ka pasur lëkundje në trendin e importeve gjatë periudhës 2000-2006, mirëpo në përgjithësi paraqitet një rënie e ndjeshme, ndërsa sa i përket çmimeve kemi rritje, kurse vlera e paguar gjatë këtyre viteve mbetet e njëjtë.

Energjia elektrike e importuar gjatë periudhës 2000-2006 dhe çmimet.

Tabela 1.6. Energjia e importuar gjatë periudhës 2000-2006; **Figura 1.4** Çmimet e energjisë prej vitit 2000-2006



1.4 Humbjet joteknike të KEK-ut

Në sistemet e energjisë elektrike humbjet janë të pashmangëshme. Humbjet e energjisë elektrike zakonisht ndahen në "humbje" teknike që janë pasojë e ligjeve të fizikës dhe humbje "joteknike" që shkaktohen nga matjet e pasakta, vjedhjet e energjisë elektrike dhe përshtatja e njësorve. Në rastin e Kosovës, një sasi shtesë e humbjeve joteknike shkaktohen nga konsumatorët që jetojnë në enklavat serbe. KEK-u nuk ka qasje për leximin e njësorve dhe dërgimin e faturave të këta konsumatorë. Sigurisht humbjet teknike janë ato që dominojnë në kushte normale, mirëpo në rastin e Kosovës janë humbjet joteknike ato të cilat janë më të larta.

Sasia ose përqindja e humbjeve teknike varet nga niveli i zhvillimit dhe kushteve të rrjeteve të transmissioinit dhe/ose shpërndarjes. Sa i përket humbjeve teknike në Kosovë, ato janë të larta nëse krahasohen me sistemet dhe rrjetat e zhvilluara energjetike, mirëpo këto humbje nuk i nënshtrohen shqyrtimit në këtë artikull.

Vëmendja i është kushtuar humbjeve joteknike të cilat në Kosovë janë të larta dhe për momentin të njëjtat duket se janë prioritet i parë në përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të Sektorit të energjisë elektrike.


Në skemën e poshtëshenuar janë paraqitur shifra statistikore për humbjet e përgjithshme, në veçanti për humbjet teknike.

Tabela 1.7 Humbjet e përgjithshme, humbjet teknike dhe humbjet joteknike

Viti/Përshkrim	2005			2006				
GWh	Total energ. në distrib.	Energjia e Faturuar	Total humbjet	Planifikuar	Total energ.	Energjia e	Total humbjet	%
Humbjet	3,883	2,010	1,873	1,833	3,896	2,046	1,850	98.97
Teknike (15%)			582	619			584	100.34
Jo-teknike			1,291	1,214			1,266	98.06

Përqindja e dhënë në skemë paraqet krahasimin e humbjet e realizuara në 2006/2005

Figura 1.5 Humbjet e përgjithshme, humbjet teknike dhe humbjet joteknike.



Sasia e humbjeve "joteknike" prej 1200 deri 1300 GWh është e madhe përtej mase për një sistem me kërkesë totale të energjisë prej 4 TWh në vit dhe është pengesë kryesore për transformimin e KEK-ut në një kompani të qëndrueshme në aspektin financiar. Nëse marrim parasysh se çmimi mesatar gjatë vitit 2006 ishte 5.12 eurocent/kWh, përkatësisht 51.00 €/MWh **atëherë humbja e të hyrave ka qenë ndërmjet 61 dhe 66 milion euro në vit që përbën rreth 37-40% të të hyrave të pritura të KEK-ut për vitin 2006.**

Duke iu referuar numrave të dhënë në skemën e lartpërmendur, aty nuk ka asnjë përmirësim gjatë vitit 2006 në krahasim me vitin 2005. Prandaj, veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti nuk kanë pasur rezultate pozitive, ose i njëjti thjeshtë e ka injoruar problemin shumë të lartë të "humbjeve joteknike".


1.5 Ristrukturimi i KEK-ut/Korporatizimi i KOSTT

Qeveria e Kosovës (IPVQ-të) në pajtim me obligimet ndërkombëtare që dalin nga Traktati KEEJL-i ka miratuar strategjinë e energjisë ku parashihet shthurja dhe restrukturimi i sektorit të vjetër të integruar vertikalisht i dominuar nga Korporata Energjetike e Kosovës dhe krijimi i Operatorit të pavarur të sistemit të transmissiionit në pajtim me kërkesat e Kapitullit IV të Direktivës Evropiane 2003/54/EC.

Ristrukturimi i KEK-ut duhet të shihet si pjesë e restrukturimit të përgjithshëm të Sektorit të energjisë elektrike në Kosovë dhe njeri nga kushtet kryesore për zhvillimin e tregut të energjisë dhe planeve të Qeverisë për privatizim në të ardhmen.

Procesi i restrukturimit dhe shthuarjës së KEK-ut është bërë paralelisht me procesin e korporatizimit të kompanive të reja pasi që një gjë e tillë ka qenë kërkesë e menjëhershme për krijimin e strukturës korporative të kësaj industrie. Në skemën e poshtëshënuar është paraqitur struktura e re e industrisë së korporatizuar dhe të shthurur nga një formë e integruar vertikalisht në shoqëri aksionare (Sh.A.).

Figura 1.6 Struktura e shthurur e KEK-ut



Kompanitë e posakrijuara gjithashtu duhet ta mbajnë strukturën e shthurur dhe të njëjtën ta bëjnë me organizatat e tyre të brendshme.

Në strukturën e KOSTT Sh.A. si Operator i sistemit të transmisionit dhe tregut (pronare e pasurive dhe kompanitë operative të transmisionit – OST dhe OT) ka përfunduar procesi i

shthurjes së kërkuar të sektorit, mirëpo KEK Sh.A. mund të vazhdoj procesin e shthurjes në të ardhmen në rast se një gjë e tillë përcaktohet nga Qeveria si qëllim strategjik.

KOSTT është themeluar më 1 janar 2006 me një vendim të marrë nga Bordi i AKM-së, mirëpo operacionet komerciale të saj kanë filluar më 1 korrik 2006. Themelimi i KOSTT-së si operator i veçantë i sistemit të transmissiionit dhe tregut nga një kompani e integruar vertikalisht është parakusht i parë për zhvillimin e çfarëdo tregu të energjisë elektrike. Kjo kompani me kornizë përkatëse rregullative duhet të jetë në gjendje të siguroj qasje të drejtë dhe transparente të palëve të treta (QPT) për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. KOSTT për më shumë duket si një hallkë shumë e rëndësishme e zinxhirit për ristrukturimin e mëtutjeshëm të pjesëve tjera të mbetura të KEK-ut (të pashturura) dhe sigurimin e hyrjeve për të porsaardhurit në tregun e energjisë elektrike në Kosovë, si gjenerues ose furnizues.

Në kuptim afatshkurtër është me rëndësi që KOSTT të arrijë kapacitetin e plotë funksional për ti përmbushur të gjitha kërkesat e shfrytëzuesve të shërbimeve të transmissiionit. Zhvillimet e tilla duhet të ndodhin kryesisht në dy drejtime në:

- shtimin e ndërtimit të kapaciteteve dhe trajnimin e stafit (tashmë ka filluar me përkrahjen e donatorëve) dhe;
- përmirësimin e dukshëm (rehabilitim - investime të reja) të kapacitetit të infrastrukturës të transmissiionit.

KEK Sh.A. duhet të vazhdojë procesin e shthurjes ashtu siç parashihet në nenin 49 të Ligjit mbi rregullatorin për energji ose nga çfarëdo qasje tjetër strategjike qeveritare e cila duhet të jetë në harmoni të plotë me Ligjin për energjinë elektrike ose cilito ligj të tjetër të zbatueshëm në Kosovë i cili në ndërkohë konsiderohet të jetë i nevojshëm. Struktura e shthurur e KEK-ut duhet të përfundoj sa më shpejtë që është e mundur për të krijuar kushte për rritjen e efikasitetit të kompanisë me synim përfundimtar për arritjen e qëndrueshmërisë së dëshiruar financiare.

KAPITULLI 2

ZHVILLIMET RREGULLATIVE GJATË VITIT 2006

2.1 Legjislacioni sekondar i miratuar në vitin 2006 dhe i paraparë për vitin 2007

Zyra e Rregullatorit për Energji gjatë vitit 2006 ka vazhduar me nxjerrjen dhe miratimin e legjislacionit sekondar (rregullave dhe dekreteve) për ta përmbushur mandatin e vet dhe përfunduar kornizën rregullative për Sektorin energjetik të Kosovës, ashtu siç është paraparë në Ligjin mbi Rregullatorin për Energji. Rregullat e nxjerra nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë janë përgatitur me përkrahjen e “projekteve të asistencës teknike” të cilat janë financuar nga USAID-i dhe AER-i.

Për secilën rregull ose dekret të nxjerrë nga ZRRE-ja është ndjekur procesi i konsultimeve publike. Drafti i çdo rregulle fillimisht është publikuar në uebfaqen e ZRRE-së dhe u është dërguar hisedarëve të ndryshëm në Sektorin e energjisë (ndërmarrjeve energjetike, ministrisë, donatorëve dhe shoqatave të ndryshme). ZRRE-ja për pranimin e reagimeve ka krijuar një adresë të postës elektronike dhe të gjitha komentet e pranuar janë mbledhur dhe proceduar nga Departamenti për Çështje Ligjore i ZRRE-së. ZRRE-ja disa javë para publikimit fillestar të draftit të rregullave ka shpallur mbajtjen e dëgjimit publik duke bërë prezantim të hollësishëm të tij. Gjithashtu, edhe komentet e pranuar nga të njëjtin janë publikuar në uebfaqe dhe janë përfshirë në draftin e rregullës e cila i nënshtrohet dëgjimit publik. Janë marrë parasysh edhe komentet e pranuar gjatë dëgjimit publik, por edhe ato të pranuar më vonë. ZRRE-ja brenda disa javësh pas dëgjimit publik ka mbajtur mbledhjen e Bordit në seancë publike për miratimin e tyre. Në seancën publike janë lexuar komentet e pranuar nga të gjithë pjestarët dhe arsyetimet për përfshirjen apo mospërfshirjen e tyre në rregulla. Pas marrjes parasysh dhe diskutimit të komenteve dhe vetë draftit, Bordi i ZRRE-së votoj për miratimin e rregullve. Pas kësaj versioni përfundimtar i rregullave është publikuar në uebfaqe. Kjo ishte procedura e cila është ndjekur për miratimin e të gjitha rregullave.

Bordi i ZRRE-së gjatë vitit 2006 në dëgjime publike ka miratuar këto rregulla:

1. Rregulla mbi procedurat e zgjidhjes së kontesteve;
2. Rregulla për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë;
3. Rregulla për çkyçe dhe rikyçe të konsumatorëve të Sektorit të energjisë në Kosovë;
4. Rregulla mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;

Gjatë vitit 2006 janë përpiluar dhe diskutuar në dëgjime publike, dhe janë në pritje të miratimit, këto rregulla:

5. Rregulla për procedurën e autorizimit të ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese;
6. Rregulla mbi masat administrative dhe gjobat ;
7. Rregulla mbi fshehtësinë e informacioneve;

ZRRE-ja më 14 shkurt 2006 ka mbajtur dëgjimin publik në lidhje me draftin e Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë dhe Rregullës për çkyqjen dhe rikyqjen e

konsumatorëve të Sektorit të energjisë në Kosovë. Këto dy rregulla u miratuan nga Bordi i ZRRE-së në seancën publike të mbajtur më 24 shkurt 2006.

ZRRE-ja më 14 mars 2006 ka mbajtur një dëgjim publik në lidhje me draftin e Rregullës për procedurën autorizuese për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese. Kjo Rregull ende nuk është miratuar për shkak të amendamenteve në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Energjinë (2004/8 dhe 2004/9) dhe kërkesës eksplicite që i është drejtuar ZRRE-së nga Ministria e Energjisë dhe Minierave për të ndërprerë miratimin e kësaj rregulle. Amendamentet e dy ligjeve ende nuk kanë kaluar në Kuvend dhe një çështje e tillë ka lënë një zbrazëti për legjislacionin e Kosovës në lidhje me lejimin dhe licencimin e projekteve për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese.

Më 27 prill 2006, ZRRE-ja ka mbajtur një dëgjim publik për Rregullën mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, e cila është miratuar nga Bordi në seancën publike të mbajtur më 28 qershor 2006.

Bordi i ZRRE-së në dëgjimin publik të mbajtur më 4 tetor 2006 lëshoi 18 licenca për gjenerim, shpërndarje, operator të sistemit transmetues, operatorë të tregut, furnizues publik dhe aktivitete tregtare në sektorin e energjisë elektrike, si dhe licenca për gjenerim, shpërndarje dhe furnizim në sektorin e ngrohjes qendrore. Gjithashtu, Bordi i ZRRE-së në seancën publike të mbajtur më 30 tetor 2006 diskutoj dhe votoj për lëshimin e licencave për 3 kompani tjera tregtare. Deri më sot ZRRE-ja ka lëshuar gjithsej 21 licenca.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit më 14 nëntor 2006 ka mbajtur një seancë publike për të diskutuar në lidhje me Rregullën mbi masat administrative dhe gjokat për ta paraqitur për konsultim publik draftin e Rregullës për fshehtësitë e informacioneve. Pritet që ZRRE-ja së shpejti ta mbajë një seancë publike për miratimin e këtyre rregullave.

Më tutje, gjatë vitit 2006, ZRRE-ja ka lëshuar disa vendime për KEK-un (Korporatën Energjetike të Kosovës) dhe kompanitë për ngrohje qendrore:

Vendimi D_12_2006	për tërheqjen e pëlqimit që i është dhënë KEK-ut më 5 qershor 2006 për eksportimin e energjisë elektrike gjatë muajve korrik dhe gusht 2006;
Vendimi D_13_2006	për miratimin e mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit (MPKK) që të aplikohet në shqyrtimin e parë të çmimeve;
Vendimi D_17_2006	për të ardhurat e lejuara për NQ “Termokos” për sezonin e ngrohjes 2006/2007
Vendimi D_18_2006	për të ardhurat e lejuara për NQ “Gjakova” për sezonin e ngrohjes 2006/2007
Vendimi D_19_2006	për miratimin e normës së interesit të normës ditore për borxhin ndaj KEK-ut (norma vjetore 14,65)
Vendimi D_20_2006	për miratimin e procedurave të përkohshme për leximin e njehsorëve dhe faturimin e konsumatorëve me maksigrafë të instaluar – dorëzuar nga Divizioni i Furnizimit dhe Shpërndarjes në KEK
Vendimi D_21_2006	për ndryshimin e Vendimit nr. D_10_2006 të datës 2 nëntor 2006.
Vendimi D_22_2006	për miratimin e tarifave për NQ “Gjakova” për sezonin e ngrohjes 2006-2007.
Vendimi D_23_2006	për miratimin e tarifave për NQ “Termokos” Sh.A.
Vendimi D_24_2006	për miratimin e tarifave për NKP “Standard” / NjNQ “Termomit” për sezonin e ngrohjes 2006-2007

Vendimi D_22_2006	për miratimin e tarifave për NKP Zveçan për sezonin e ngrohjes 2006-2007.
Vendimi D_29_2006	për miratimin të ardhurave të lejuara për KOSTT-në dhe KEK-un për periudhën rregullative 2007-2009.
ERO_EC_002_06	statusi i konsumatorit të privilegjuar për vitin 2006 për SHARR BETEILIGUNGS GmbH.

2.2 Aktivitetet e licencimit

Një nga detyrat kryesore të ZRRE-së të përcaktuara me ligj është zhvillimi i kriterëve për licencim, dhënia e licencave për ndërmarrjet energjetike dhe monitorimi i aktiviteteve të licencimit. Licenca është një përmbledhje e dispozitave relevante të cilat janë të bazuara në: Ligjin për Energjinë (2004/8), Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (2004/9), Ligjin për Energjinë Elektrike (2004/10), Ligjin për Ngrohjen Qendrore, Rregullën për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, Pasqyrën e taksave dhe rregullat tjera të miratuara nga Bordi i ZRRE-së.

Licenca përmban kushtet dhe obligimet e domosdoshme të cilat do t'i përmbush i licencuari dhe për të cilat do të bëhet monitorimi nga ZRRE.

Në Rregullën për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë parashihet që ndërmarrjet të cilat dëshirojnë të kryejnë aktivitete për energji elektrike dhe ngrohje duhet të aplikojnë për licencë në ZRRE – Departamenti Ligjor dhe i Licencimit. ZRRE-ja do të lëshojë licencat e tyre brenda 90 ditësh pas ditës së dorëzimit të aplikacionit. Palët e interesuara për licencim, mund ta gjejnë aplikacionin për licencë, i cili është publikuar në uebfaqën zyrtare të ZRRE-së. ZRRE-ja deri më 24 qershor 2006 ka pranuar 21 aplikacione për licencë për energji elektrik dhe ngrohje qendrore dhe për të njëjtat ka bërë lëshimin e licencave. Këto licenca janë të publikuara në uebfaqën e ZRRE-së në formë të regjistrimit të licencave, i cili përmban këto licenca:

Licenca për tregtim/furnizim me energji elektrike për ČEZ" a.s. / Republika Çeke;
 Licenca për tregtim/furnizim me energji elektrike për HSEd.o.o nga Sllovenia;
 Licenca për tregtim/furnizim me energji elektrike për OstElektraGmbH nga Gjermania;
 Licenca për gjenerimin e energjisë elektrike për KEK Sh.A. për TC Kosova A;
 Licenca për gjenerimin e energjisë elektrike për KEK Sh.A. për TC Kosova B;
 Licenca për gjenerimin e energjisë elektrike për "Triangle General Contractors Inc" për HC "Lumbardhi"
 Licenca për gjenerimin e energjisë elektrike për NP "Ibër Lepenci" për HC "Ujmani";
 Licenca për operator të sistemit të transmissiionit për KOSTT;
 Licenca për operator të tregut të energjisë elektrike për KOSTT;
 Licenca për operator të sistemit të distribucionit të energjisë elektrike për KEK Sh.A.
 Licenca për furnizues publik me energji elektrike për KEK Sh.A.;
 Licenca për tregtim/furnizim me energji elektrike për KEK Sh.A.;
 Licenca për tregtim/furnizim me energji elektrike për EFT AG, Zvicër;
 Licenca për tregtim/furnizim me energji elektrike për EGL AG, Zvicër;
 Licenca për tregtim/furnizim me energji elektrike për Ezpada S.R.O, Republika Çeke;
 Licenca për gjenerim të ngrohjes qendrore për NP "Termokos";
 Licenca për shpërndarjen e ngrohjes qendrore për NP "Termokos";
 Licenca për furnizues publik të ngrohjes qendrore për NP "Termokos";
 Licenca për gjenerim të ngrohjes qendrore për NP "KNQ Gjakova";
 Licenca për shpërndarjen e ngrohjes qendrore për NP "KNQ Gjakova";
 Licenca për furnizues publik të ngrohjes qendrore për NP "KNQ Gjakova";

Në vitin 2007, ZRRE-ja do të filloj me monitorimin e aktiviteteve të të licencuarve. ZRRE-ja për të ndihmuar të licencuarit ka publikuar doracakun për raportim ku përcaktohet mënyra dhe forma e raporteve të cilat duhet të dorëzohen për çdo tremujor dhe çdo vit në ZRRE. ZRRE-ja në fillim të muajit janar 2007 ka mbajtur një mbledhje pune të njohur si “punëtori” për të shpjeguar dhe diskutuar kërkesat për raportim, format e raportimit dhe afatet. Të gjithë të licencuarit kanë dorëzuar raportet vjetore deri më 30 shkurt 2007 dhe ZRRE-ja është në proces të vlerësimit të tyre.

2.3 Kodet teknike/qeverisja e kodeve – mekanizmi përcaktues për kapacitetet e transmissioinit ndërlidhës

Kosova sipas obligimeve që dalin nga Traktati i KEEJL-it duhet të liberalizojë Sektorin e energjisë dhe ta hap këtë sektor për konkurrencë e cila do ti përfshijë të gjithë konsumatorët e final. Qëllimi i reformave dhe strukturimit të Sektorit të energjisë të cilat gjatë 15 – 20 vitet e fundit janë bërë në gjithë botën, është rritja e efikasitetit dhe produktivitetit përmes paraqitjes së disiplinës dhe konkurrencës në treg. Konsumatori i final përfiton nga kualiteti më i mirë i shërbimeve dhe nga siguria e furnizimit, ndërsa çmimi i tregut ofron “sinjal të saktë ekonomik” për investime dhe menaxhim rreziku.

Rëndësi të veçantë në krijimin e konkurrencës në Sektorin e “rrjetit të energjisë”, i ashtuquajtur “parimi i qasjes së palës së tretë” (QPT), për të cilin janë krijuar mekanizma për qasje të drejtë dhe transparente për të gjithë pjesëmarrësit e tregut në rrjetet e monopolit. Pasi që biznesi i qarqeve në Sektorin e energjisë është “monopol natyror” për shkak të kostos së zhytur shumë të lartë dhe karakteristikës së ekonomisë së përmasës, ekziston nevoja për të siguruar se çdonjeri i cili ka dëshirë të gjeneroj/furnizoj/konsumoj energji elektrike të ketë qasje transparente dhe të barabartë në rrjete. Prandaj bizneset e qarqeve (transmisioni/shpërndarja) si rrjedhim mund të “shthuren” si aktivitete të veçanta nga ato aktivitetet konkurruese (gjenerimi – furnizimit) dhe të veprojnë të pavarura si monopole natyrore dhe sipas parimit të QPT-së të mundësojnë krijimin e tregut konkurrues në këtë sektor. Mekanizmi QPT përbëhet nga dy pjesë fundamentale përbërëse: 1) metodologjia për çmimet e rrjetit (për shfrytëzim, kyçje dhe qasje në rrjete) dhe b) rregullat të cilat rregullojnë të drejtat dhe obligimet e palëve të cilat kanë qasje fizike në rrjete (kodet teknike).

Legjislacioni i Kosovës për energji është plotësisht në harmoni me legjislacionin e komunitetit (“Acquis Communautaire”) dhe parasheh shturje të plotë të sektorit (kapitulli 10 i Ligjit 2004/9 për Rregullatorin e energjisë). Parimi i QPT-të njihet gjithashtu me ligjet bazë të Kosovës (Ligji 2004/10 për Energjinë Elektrike – nenet 13.2 dhe 38.7) dhe parashihet zhvillimi i kodeve teknike nga Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT) dhe miratimi i tyre nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Ligji për Energjinë Elektrike parasheh miratimin nga Rregullatori i kodeve teknike të dhëna më poshtë:

- Kodi i rrjetit
- Kodi matës
- Kodi i shpërndarjes
- Kodi i standardit të energjisë elektrike
- Kodi i pajisjeve elektrike
- Kodi për mbrojtjen e konsumatorit

ZRRE-ja bazuar në kërkesën e dorëzuar nga KOSTT-ja më 20 dhe 28 dhjetor 2006 ka shqyrtuar dhe miratuar Kodin i rrjetit dhe Kodin matës përmes vendimit nr. D_31_2006 të datës 30 janar 2007, të cilat tani përbëjnë legjislacion sekondar për Sektorin e energjisë në Kosovë. Kodet e tjera janë në procesin e zhvillimit nga KOSTT-ja.

Deri më tani, kodi më i rëndësishëm teknik në çfarëdo sektori të ristrukturuar të energjisë është Kodi i rrjetit. Kodi i rrjetit është një dokument i vetëm ligjërish i detyrueshëm i cili mbulon të gjitha çështjet teknike dhe komerciale, procedurat, të drejtat dhe obligimet, si dhe ndërlidhjet ndërmjet operatorëve të sistemit të transmissioinit dhe të gjithë shfrytëzuesve tjerë të kyçur në rrjetin e transmissioinit. Në kodin e rrjetit janë të trajtuara këto çështje:

- planifikimin dhe zhvillimin e sistemit të transmissioinit në Kosovë;
- kyçjen në sistemin e transmissioinit të Kosovës;
- planifikimin operativ i cili përbëhet nga: ndërprerjet, vlerësimi i sigurisë së sistemit dhe parashikimi i kërkesës, procesi i planifikimit një ditë më herët;
- balancimi i cili përbëhet nga: procedurat dhe proceset për dispeçing për balancim, shërbimet ndihmëse, proceset për kontrollin e frekuencës së sistemit, rregullimet për kontrollin e voltazhit dhe reaksionit;
- operacionet që përbëhen nga: testimi dhe monitorimi, shkëmbimi i informatave në kushte normale dhe jonormale, procedurat për lejimin e punëve dhe/ose testimet që do të ndërmerren përgjatë një pike të kyçjes, provizionet për planet për situata të jashtëzakonshme dhe të restaurimit pas rënies së tërësishme apo të pjesërishe të sistemit, kontrolli i kërkesës etj.
- procedurat për trajtimin e rrethanave të paparashikueshme, kontestet, rrëmbimet dhe ndryshimet e kodit të rrjetit janë të parapara në kapitullin e kushteve të përgjithshme.

Rregulla mbi kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji e rregullon në hollësi çështjen e procedurave komerciale në lidhje me kyçjen fizike në rrjete.

Kodi matës përcakton specifikacionet dhe përshkruan pajisjet apo veglat matëse që përdoren për qëllime komerciale (marrëveshje, etj) të cilat kërkojnë të jenë në të gjitha pikat lidhëse ndërmjet rrjeteve, rrjeteve dhe njësive gjeneruese dhe në pikat e furnizimit të konsumatorëve. Përkufizon të drejtat dhe obligimet që secila palë ka ndaj paisjeve apo veglave matëse, e në veçanti për ato të operatorëve të rrjetit duke përfshirë edhe të rregullatorit. Përfshinë çështje në lidhje me sigurinë e sistemeve dhe fshehtësinë e të dhënave të njesimit. Kodi matës jep në hollësi standardet minimale për matjen dhe evidentimin e energjisë (sasitë e njesuara) të cilat do të përdoren për shitjet dhe blerjet e energjisë elektrike në tregun e energjisë – përfshirë këtu edhe ato të domosdoshme për tregtimet që kanë origjinë apo që përfundojnë jashtë Kosove. Për më shumë, Kodi matës përcakton dispozitat në lidhje me instalimin, testimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemeve dhe pajisjeve matëse përfshirë këtu edhe lidhjet përkatëse të komunikimit. Kodi matës gjithashtu përcakton kërkesat e përafërsisë, parametrat që duhet të maten, mirëmbajtjen dhe testimin e kërkesave.

Zhvillimi dhe miratimi i kodit të rrjetit dhe kodit matës për Kosovën shënon një pikë të rëndësishme referimi për zhvillimin e një tregu konkurrues të energjisë.

ZRRE-ja, bazuar në mandatin e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë ka zhvilluar dhe miratuar (Vendimi D_31_2007, i datës 30 janar 2007). Procedurat qeverisëse për kodet teknike operacionale si kërkesë për administrimin e kodeve të lartpërmendura teknike. Kodet, gjithashtu edhe rregullat të cilat përbëjnë legjislacionin sekondar të sektorit tonë të energjisë janë dokumente dinamike “të gjalla” të cilat i nënshtrohen modifikimeve dhe ndryshimeve të cilat mund të propozohen nga pjesëmarrësit e tregut, mirëpo duke iu nënshtruar miratimit përfundimtar nga ZRRE-ja. Procedurat për qeverisjen e kodeve teknike/operacionale merren me:

- një organ përkatës të industrisë për shqyrtime dhe diskutime periodike të kodit të rrjetit, kodit të shpërndarjes, kodit matës, kodit të standardeve të energjisë elektrike, kodit të pajisjeve elektrike dhe kodit për mbrojtjen e konsumatorëve;
- procedurat për shqyrtimin, diskutimin dhe dorëzimin e të gjitha modifikimeve dhe amendamenteve në kodin e rrjetit, kodin e shpërndarjes, kodin matës, kodin e standardeve të energjisë elektrike, kodin për pajisje elektrike, kodin për mbrojtjen e konsumatorit ku OPSTT (KOSTT), OSSh (KEK), ZRRE-ja ose çfarëdo pjesëmarrësi i tregut ose çfarëdo pjesëmarrësi potencial i tregut mund t’ia dorëzoj OPSTT (KOSTT) për tu marrë parasysh kohë pas kohe nga KQKO (Komisioni qeverisës i kodeve operacionale i themeluar me procedurat e qeverisjes).

Kosova sipas obligimeve që dalin nga traktati KEEJL duhet të jetë në harmoni me Rregulloren 1228/03/EC për “kushtet e qasjes në rrjet për shkëmbime ndërkufitare të energjisë elektrike” e cila në mes tjerash në nenin 6 përcakton udhëzime për ofrim të drejtë dhe jodiskriminues të të drejtave të qasjes në ndërlidhjet ndërkombëtare për pjesëmarrësit e tregut. Legjislacioni i Kosovës është në harmoni të plotë me legjislacionin Evropian për energji i cili rregullon këtë çështje. ZRRE-ja sipas mandatit të saj të përcaktuar me nenin 25.1 të Ligjit 2004/10 për Energjinë Elektrike dhe nenin 15.4 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, bazuar në propozimin e dorëzuar nga KOSTT-ja. ZRRE-ja (me vendimin nr. D_33_200 të datës 31 janar 2007) ka miratuar “procedurat për alokimin e kapaciteteve transmetuese”.

Procedurat operacionale mbulojnë metodologjinë për alokimin e kapaciteteve transmetuese në dispozicion në linjat lidhëse me vendet fqinje përmes procesit të ankandëve eksplicite (mekanizëm i bazuar në treg i kërkuar në Rregulloren 1228). KOSTT-ja do të bëjë të gjitha marrëveshjet bilaterale me OST-të fqinje. Në rast të mungesës së marrëveshjes KOSTT-ja do të alokojë 50% të AKT në kufirin përkatës. Ky mekanizëm do të jetë në fuqi deri në momentin kur të përfundojë “mekanizmi për koordinim të plotë të alokimeve” i cili është në zhvillim nga OSTEJL. Meqenëse OST-ja e Kosovës (KOSTT) është në rrugën e anëtarësimit të plotë në OSTEJL, ky operator ende nuk është palë në mekanizmin e alokimit për shkak të kundërshtimit nga Serbia (RREES).

Miratimi i procedurave për alokimin e kapaciteteve në ndërlidhjet e Kosovës është një pikë tjetër referuese e arritur gjatë vitit 2006, e cila do të mundësojë konkurrencë dhe transparencë në tregun e shitjes me shumicë (importet/eksportet).

2.4 Rregullat e përkohshme të tregut

Kosova sipas legjislacionit ndërkombëtar duhet që në Sektorin e energjisë elektrike të implementoj një treg të organizuar të konkurrencës. Tregu i organizuar në Sektorin e energjisë gjithashtu është kërkesë në harmoni me direktivat Evropiane për energji, që kërkohet me Traktat sipas të cilit është themeluar komuniteti energjetik i Evropës Juglindore (KEEJL). Kërkesat e tilla janë ndarja e funksioneve (OST-së, OT-së, OSSh-së, Gencos dhe furnizuesve), krijimi i kushteve për qasje të palës së tretë (QPT), krijimin e konsumatorëve të privilegjuar (që e bën të domosdoshme çmimvënien efikase për shmangien e subvencioneve të ndërthura për konsumatorët kaptiv) dhe zgjedhja e furnizuesit si dhe krijimi i tregjeve regjionale. Arsyeja e futjes në përdorim të disiplinës tregtare dhe konkurrencës në Sektorin e energjisë elektrike është përmirësimi i efikasitetit ekonomik përmes vënies së çmimeve (çmimvënie sipas kostos marginale) për dispeçing efikas (forma e çmimit – kapaciteti i bazës së kostos operative të lirë e cila siguron kontribut në kostot fikse – kapaciteti i pikut (më i lartë) i cili siguron kontribut racional në koston fikse – vlerësim racional për importet dhe eksportet, ndërsa për gjeneratorin e ri dhe pjesëmarrësit e rinj nevojitet rrjedha e të hyrave të bazuara në kosto për uljen e rrezikut. Rreziku i arsyeshëm bën joshjen e kapitalit e jo vetëm mbështetjen në garancitë e çmimeve dhe mjedisi i rrezikut që përkrah kapitalin privat funksionon vetëm me çmimvënie racionale. Në anën tjetër, Tregjet rajonale janë krijuar për të shfrytëzuar përparësitë e ekonomisë së përmasës, uljen e fuqisë së tregut dhe optimizmin e shumëllojshmërive të mundësive të gjeneruara (me bazë linjiti – hidro në rast të pikut) ndërsa në anën tjetër duke rritur sigurinë e furnizimit. Tregjet ekzistojnë për: liferim të energjisë sipas obligimeve kontraktuese – transferimin e rrezikut financiar – çmimvënie efikase.

Siç është theksuar në Raportin vjetor për vitin 2005, ZRRE-ja është autorizuar nga Qeveria për zhvillimin e një modeli të përshtatshëm të tregut për Kosovë, si dhe rregullat përkatëse, veprim ky i ndërmarrë gjatë vitit 2005 dhe 2006. ZRRE-ja me konsulentët e saj dhe përmes konsultimeve publike me kujdes ka shtjelluar zgjedhjet përkatëse për modelin e tregut në Kosovë dhe në fund vendosi në lidhje me modelin e llojit “Net Pool” me kontrata bilaterale dhe me mekanizëm balancues në kohë reale. Zgjedhja e “Net Pool” është bërë duke u bazuar në atë se ky lloj tregu më lehtë mund të merret me çështjet e ndërlidhjes (interkoneksionit), prandaj edhe është më i favorshëm për tregtim rajonal.

Kështu që, ZRRE-ja përpiloi rregulla të hollësishme të tregut për modelin “Net Pool” me mekanizëm balancues në kohë reale dhe me një mekanizëm të certifikatave të kapacitetit për të nxitur krijimin e njësisë të reja gjeneruese. ZRRE-ja për shkak të likuiditetit të mjaftueshëm për shtytjen e tregut të plotë, në të njëjtën kohë dhe për një periudhë të përkohshme bëri dizajnimin e një “modeli të tregut të stimuluar” për të stimuluar “çmimet e tregut” për orë për të shfrytëzuar stimulimin e çmimeve për nxjerrjen e çmimeve me shumicë të gjenerimeve të KEK-ut. Në rregullat e tregut është përshkruar roli, të drejtat dhe obligimet si dhe ndarja e funksioneve të secilit subjekt të licencuar nga ZRRE-ja (operatori i sistemit të transmisionit – OST, Operatori i tregut, operator i rrjetit të shpërndarjes – ORrSh, gjeneruesit, furnizuesit përfshirë këtu furnizuesin publik dhe konsumatorët e privilegjuar dhe mënyrën se si krijohet, kontraktohet, matet dhe paguhet energjia, kapaciteti dhe shërbimet ndihmëse). Roli i rregullave të tregut është që të përshkruhet ndërveprimi ndërmjet ligjeve për kontrollin e çmimit, palëve, licencave dhe kodeve.

Parimet e dizajnit të tregut janë:

- tregjet e energjisë, kapacitetit dhe shërbimeve ndihmëse;
- marrëveshjet;
- operimi i tregut dhe mekanizmi balancues;
- qeverisja e rregullave;
- mekanizmi për certifikatat e kapacitetit.

Në shtojca janë përshkruar modelet për caktimin e çmimit dhe marrëveshjet kontraktuese (marrëveshjet për hyrje dhe marrëveshjet kornizë).

Përkundër përparimit të shpejtë të arritur në themelimin dhe implementimin e Operatorit të pavarur të sistemit të transmissioinit dhe tregut (OSTT), infrastrukturën e sistemit (kryesisht njesimi), kushtet e sistemit në gjenerim dhe mihje, faktin se vetëm një konsumator i privilegjuar ka kërkuar kontratë me furnizuesin publik për furnizim afatgjatë, por edhe çështjet rajonale (siç është vazhdimi i përjashtimit të KOSTT-së nga mekanizmat e OSTEJL-it, pastaj TNK dhe CCA-ja), rreth mesit të vitit 2006 u bë e qartë se nuk mund të bëhet implementimi i plotë i modelit. Në të vërtetë nuk ka pasur asnjë arsye praktike për zbatimin e plotë të modelit të tillë. Prandaj është vendosur që ZRRE-ja dhe KOSTT-ja bashkërisht të zhvillojnë një version më të thjeshtë të modelit që është modeli i përkohshëm i tregut T1, i cili nga data 1 prill 2007 do të zbatohet nga të gjithë pjesëmarrësit e tregu dhe i cili do të mbetet në fuqi për së paku një vit. Rregullat e përkohshme të tregut përbëhen nga pesë kapituj, siç janë:

- I. Klauzolat preliminare (objektiva, përmbajtja, përkufizimet dhe emërtimet, palët dhe llogaritë, hyrja në rregullat e tregut dhe ndërprerjes, komunikimet operative, tregtimi ndërlidhës – ndjekja e rregullave rajonale);
- II. Operimi i sistemit (parashikimi i kërkesës, gjenerimit, emërtimi i ndërlidhjeve);
- III. Pagimi (llogaritja e pagesës për energji, të dhënat e palëve të drejta, ngarkesat e drejtpërdrejta të KOSTT-së, taturimi i palëve të treta, faturimi dhe pagesat);
- IV. Qeverisja (procedurat operative, modifikimi i RRT-ve, dispozitat e përgjithshme, qasja në RRT, njoftimet dhe data e fillimit, forca madhore, dispozitat e transferimit dhe fshehtësitë, përgjegjësia, valuta dhe juridiksioni);
- V. Shtojcat (marrëveshja kornizë dhe marrëveshja për hyrje);

Ky model është i përshkruar në diagramin 2.1 më poshtë, ndërsa në diagramin 2.4.2 përshkruhen rrjedhat financiare.

Figura 2.1 Tregu i energjisë elektrike





Figura 2.2 Rrjedhat financiare



Në këtë implementim të thjeshtë të “Net Pool” do të mbahen vetëm dy llogari të energjisë: pozicioni i energjisë neto të **KEK-ut** dhe pozicioni i **humbjeve të transmisionit të KOSTT**. Llogaria e energjisë së KEK-ut nuk do të rregullohet financiarisht në mënyrë të drejtpërdrejtë. Megjithatë **KEK-u** do të jetë përgjegjës që gjatë gjithë kohës të mbaj në zero pozicionin e energjisë neto në pajtim me Kodin i rrjetit. Në modelin e përkohshëm nuk përdoret mekanizmi balancues si dhe mekanizmi i certifikatës së kapacitetit.

Aktualisht procesi i marrëveshjes nuk përdor oferta dhe ngarkesa për mosliferim e as nuk krijon çmime çorientuese të energjisë gjatë **periudhës për shlyerjen e obligimeve**. **Totali mujor neto i gjenerimit** është i barabartë me outputet e gjenerimit të termocentralit të cilat kalojnë në sistemin e transmisionit gjatë muajit minus ngarkesat e njësisë transformuese dhe ngarkesat e transformatorit të centralit brenda kufirit komercial ndërmjet gjenerimit dhe transmisionit. **Liferimi llogarisë mujore të gjeneratorit** për secilin gjenerator “A” është i barabartë me shumën e gjenerimit që kalon në TS gjatë muajit minus ngarkesat shoqëruese të termocentralit ngarkesat për njësi transformuese dhe ngarkesat e transformatorit të centralit brenda kufirit komercial ndërmjet gjenerimit dhe transmisionit.

KEK-u është përgjegjës që gjatë kohës të mbajë neto pozicionin zero për llogarinë e **pozicionit të energjisë neto të KEK**. Sa i përket kësaj, **OST**-së i kërkohet të planifikojë rrjedhat balancuese në pajtim me marrëveshjet rajonale dhe **KEK-u** do të gjenerojë, reduktojë ose aranzhojë tregtimet e ndërlidhjes për të arritur apo plotësuar rrjedhat e planifikuara. Në rastet kur KEK-u dështon në mbajtjen e bilancit dhe OST detyrohet të pranojë tregtimin balancues, atëherë përgjegjësia financiare për këtë i takon KEK-ut.

Për qëllime të caktimit të detyrimeve për **ngarkesën e furnizuesit të rrjetit të transmisionit** është e nevojshme të bëhet llogaritja e kërkesave të pesë orëve me kërkesë më të lartë plus humbjet e vitit. Vëni re se kërkesa plus humbjet janë të barabarta me minus gjenerimin - minus importet neto. Rrjedhat e gjenerimit dhe të ndërlidhjes janë automatikisht në dispozicion në vlera të periudhave 15 minutëshe ndërsa e njëjta nuk vlen për kërkesën.

Faturat iu shpërndahen **palëve tregtuese** dhe të tjerëve nga **OT-ja** një herë në muaj. Palët tregtuese dhe të tjerët duhet të pastrojnë apo shlyejnë të gjitha paratë që janë shfaqur për muajin paraprak kalendarik në pajtim me orarin e shlyerjes së detyrimeve. Faturat do të shpërndahen për transaksionet e dhëna në vijim:

- a) pagesat dhe shpenzimet direkte të **KOSTT-së**;
- b) ndërmjet furnizimit të **KEK-ut** dhe gjenerimit të **KEK-u**;
- c) ndërmjet **furnizimit të KEK-ut** dhe **importuesve**;
- d) ndërmjet **eksportuesve** dhe **furnizimit të KEK-ut**;
- e) ndërmjet **furnizimit të KEK-ut** dhe **gjeneruesve të pavarur**;
- f) ndërmjet **furnizimit të KEK-ut** dhe **konsumatorëve të privilegjuar**;
- g) ndërmjet **distribucionit të KEK-ut** dhe **furnizimit të KEK-ut**.

h) KAPITULLI 3

ZHVILLIMI I KAPACITETIT TË RI GJENERUES (ME LINJIT) DHE MINIERA SHOQËRUESE

3.1 Projekti i asistencës teknike për energji nga linjiti - PATEL

3.1.1 Historiku

Energjia dhe xehetaria (minierat) historikisht kanë qenë dhe janë shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë ka siguruar vende pune, burime të të hyrave, të ardhura eksporti dhe inpute në industrinë vartëse. Megjithatë, Sektori i energjisë nga kontribuuesi i zhvillimit ekonomik është shndërruar në shterës i resurseve publike. Për më shumë, furnizimi i paqëndrueshëm me energji elektrike është bërë një ndër pengesat kryesore të zhvillimit pasi që Kosova vazhdon të vuaj nga reduktimet e rregullta të energjisë elektrike, me një mesatare në vitin 2005 prej 4 orë në ditë, e deri në 6 orë në ditë sa ishte në vitin 2002. Kompanitë që kanë qenë pjesë e hulumtimit në Kosovë kanë raportuar se mungesa e furnizimit të qëndrueshëm me energji është barriera kryesore e aktiviteteve apo operacioneve të tyre, gjë që ka rezultuar me një mesatare të humbjes prej 5 për qind të shitjeve (duke mos përfshirë çmimin e blerjes dhe shpenzimet e gjeneratorëve).

Burimi kryesor i energjisë elektrike në Kosovë janë rezervat e mëdha të linjtit të cilat vlerësohen të jenë 11 miliard ton, e të cilat janë më të mëdhat në tërë rajonin e EJT-së, ndërsa në anën tjetër, Kosova ende nuk ka infrastrukturë për importimin e gazit, ka potencial shumë të kufizuar ujrash dhe nuk ka ndonjë rafineri naftë, si dhe varet tërësisht nga importi i lëndëve djegëse të lëngëta. Për shkak të proporcionit tejet të volitshëm të mbingarkesës, vlerës relativisht të lartë të kalorive dhe përqindjes së ulët të squfurit, linjiti i Kosovës nga shumë parastudime të realizueshmërisë është vlerësuar si derivati më ekonomik (me kosto më ulët) për zhvillimin e një baze të gjenerimit në tërë rajonin e EJT-së.

Kapacitet aktualë të gjenerimit të energjisë që KEK-u i ka në dispozicion në termocentralet Kosova A dhe B janë kapacitete të vjetra dhe joadekuate për plotësimin e kërkesave. Në të njëjtën kohë është duke u rritur kërkesa industriale dhe kompania për miniera e privatizuar kohëve të fundit (Ferronikeli) nga viti 2007 e tutje do të ketë nevojë për 100 MW. Kjo do të tendosë edhe më shumë baraspeshën ndërmjet kërkesës dhe ofertës dhe reduktimet e mëtutjeshme do të ndikojnë edhe më shumë në rritjen e ekonomike, ose si alternativë importet do të jenë më të kushtueshme (në veçanti nëse marrim parasysh situatën shumë të vështirë të furnizimit në EJT). Termocentrali Kosova B (me dy njësi të instaluar në fillim të viteve 80) është rehabilituar dhe kohëzgjatja e funksionimit të tyre është zgjatuar deri në vitin 2025. Sa i përket Kosovës A (me 5 njësi të instaluar ndërmjet 1964 dhe 1974), rehabilitimi i tri njësive (A3, A4 dhe A5) secila me kapacitet nominal 200 MW) për zgjatjen e kohës së funksionit për 12 deri 15 vite është i realizueshëm në aspektin teknik, mirëpo pasi që harmonia me standardet e BE-së për mjedis është shumë e kushtueshme atëherë si përfundim nuk pritet që këto njësi të jenë me kosto efektive në krahasim me termocentralin e ri. Konsiderohet si i arsyeshëm remonti i këtyre njësive për të

zgjatur kohën e funksionit deri në kohën kur termocentrali i ri futet në funksion. Më tutje, parashihet një mungesë e madhe e furnizimit me linjit nga viti 2009 e tutje, pasi që minierat ekzistuese (Bardh dhe Mirash) janë duke u shterur dhe për shkak të mjeteve financuese ka pasur vonesa në fillimin e punëve zhvillimore në minierën e re të KEK-ut (fusha Sibovc Jugperëndim). Kostoja e zhvillimit të minierës së re për një periudhë 7 vjeçare parashihet të jetë 236 milion Euro.

3.1.2 Strategjia e Qeverisë

UNMIK-u dhe IPVQ-të kanë bashkëpunuar në zhvillimin e një strategjie¹ gjithëpërfshirëse për Sektorin e energjisë e cila ka për qëllim të adresojë çështjet dhe sfidat afatshkurtra dhe afatgjata dhe ta vejë sektorin në një rrugë të zhvillimit dhe të rritjes afatgjate në harmoni me direktivat dhe standardet e BE-së. Objektivi kryesor i qeverisë është që Sektorin e energjisë ta bëjë të vetëfinancueshëm dhe që sa më parë të sillen apo të përfshihet sektori privat. Prandaj duke pasur parasysh nevojën për të pasur një kohë të dukshme zbatimi para zgjedhjes së investitorëve, e në anën tjetër nevojën imediate për mbajtjen e furnizimit me energji dhe linjit, kjo strategji lejon përkrahje nga BKK-ja dhe donatorët gjatë periudhës 2006-2007. Elementet kyçe të strategjisë janë "Përforsimi i financiare të KEK-ut" përmes përmirësimit të faturimit dhe arkëtimit dhe uljes së nivelit të vjedhjes së energjisë dhe "Prioritetet për përkrahje buxhetore" për aktivitetet e reja të mihjes.

Mirëpo, elementi më i rëndësishëm i strategjisë janë "investimet e sektorit privat". Qeveria synon të joshë kapitalin dhe përvojën e sektorit privat në minierat e linjitet dhe gjenerimin e energjisë elektrike duke ofruar minierën e Sibovcit (përafërsisht 800 milion ton rezerva), përfshirë këtu edhe minierën Sibovc JP, për furnizimin e termocentraleve të KEK-ut, dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja (Kosova C) për furnizimin e tregut të brendshëm dhe rajonal që dalin nga Traktati i KEEJL-it për energji elektrike.


Me ndihmën e Bankës Botërore dhe AER-it ky proces ka filluar në vitin 2006 dhe shqyrtimi i mundësive për investime ka filluar dhe konsulentët kanë identifikuar një pako të realizueshme të pasurive të KEK-ut e cila përbëhet nga një fushë për minierë dhe termocentral, e cila do t'i ofrohet investitorëve të kualifikuar nga sektori privat për ofertim në një proces të hapur dhe konkurrues të ofertimit me ndihmën e një këshilltari për transaksion. Qeveria ka për synim të miratojë dhe adoptojë standarde të larta të ruajtjes mjedisore dhe sociale të qeverisura nga direktivat e BE-së dhe të zhvillojë politikat e saj të sektorit dhe kornizat ligjore dhe rregullative. Gjithashtu do të bëhen reforma dhe ristrukturim të sektorit në harmoni me dispozitat e Traktatit të KEEJL-it, përfshirë këtu edhe liberalizimin për zhvillimin e tregjeve.

3.1.3 Situata aktuale e minierave dhe furnizimit me linjit

Tërë linjiti i cili aktualisht nxirret në Kosovë dhe përdoret për gjenerimin e energjisë elektrike vjen nga dy miniera sipërfaqësore: miniera e Bardhit dhe Mirashit. Këto dy miniera janë në funksion që nga viti 1958 dhe aktualisht janë para shterjes. Sipas nivelit të projektuar të konsumit i cili është 6.8 milion ton në vit, niveli i prodhimit të linjitet nga këto miniera do të fillojë të bie në vitin 2008, siç është ilustruar më poshtë.

¹ Strategjia dhe politika energjetike të Kosovës, "(dokument i Bardhë)" 2005-2015, korrik 2005

Figura 3.1 Prodhimi i projektuar për të ardhmen nga miniera e Bardhit dhe Mirashit, burimi: KEK, MEM



Zhvillimi i minierës “Sibovc JP” është i rëndësishë thelbësore për mbajtjen e nivelit të furnizimeve të Kosovës A dhe B pas vitit 2008, kur do të filloj shterja² e rezervave të mbetura të Mirashit dhe Bardhit. Dështimi i fillimit të funksionimit të minierës së re në vitin 2009 do të rezultoj me ndërprerje të furnizimit me lëndë djegëse dhe ndërprerje të disa apo të gjitha njësive gjeneruese të energjisë elektrike. Si rrjedhim, vetëm për furnizimin e termocentraleve ekzistuese në Kosovë dhe mbajtjen e niveleve të ekzistuese të prodhimit duhet të bëhen investime të mëdha në zhvillimin e minierave.


Tabela 3.1 Burimi: Kostoja e zhvillimit të Minierës “Sibovc JP”, Steag, Maj 2006

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Totalet
eskavator, transportues, sisteme grumbullimi	0.6	28.6	51.4	54.8	21.5	16.5	9.4	182.2
furnizimi/infrastruktura e energjisë	0.7	3.9	12.3	7.8	5	2.1	1.1	32.9
blerja e tokës/rivendosja/tjera	1.4	5.7	4.5	2.9	1.9	1.9	1.9	20.2
Totalet	2.7	38.2	68.2	65.5	28.4	20.5	12.4	235.9

Për zhvillimin e minierës së re njëkohësisht nevojitet të bëhen disa aktivitete të mëdha: (a) analiza inxhinierike për përgatitjen e specifikacionit teknik për punë, mallra dhe shërbime, (b) rehabilitimi i pajisjeve kryesore të mihjes të marra nga operacionet ekzistuese, (c) likuidimii i materialeve të tepërta (mbingarkesa), dhe (d) zhvillimi i infrastrukturës përkrahëse. Planifikimi i zhvillimit të minierës “Sibovc SW” është dashur të filloj në vitin 2002 me analizat preliminare inxhinierike dhe blerjen e tokës. Rehabilitimi kryesor i pajisjeve dhe puna tokësore është dashur të fillojnë në vitin 2005. Në bazë të këtyre informatave mund të themi se procesi i zhvillimit të minierës “Sibovc JP” është 18 muaj prapa. Ky proces është në vonesë e sipër dhe si i tillë vazhdon edhe më tutje drejtë datës së përfundimit e cila është fikse. Linjiti nga kjo minierë është i nevojshëm deri në vitin 2009, në mënyrë që gjenerimi i energjisë të mbahet aktiv. Zhvillimi i minierës “Sibovc JP” në këtë moment duhet të konsiderohet si veprim emergjent për mbajtjen e furnizimit të Kosovës A dhe B me lëndë djegëse.

² Plani plotësues i mihjes për Minierën në Jugperëndim të Sibovcit, Steag, prill 2006

Figura 3.2



3.1.4 Përkrahja e donatorëve

Diskutimet teknike të mbajtura më 24-25 mars dhe 20-22 qershor kanë rezultuar me një marrëveshje të lidhur ndërmjet përfaqësuesve të Misionit të Përkohshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në zyrat e AZHN-së në Prishtinë, për një grant nga Asociacioni për Zhvillim Ndërkombëtar (Granti). Banka Botërore përmes PATEL-it të propozuar është duke ofruar përkrahje për implementimin e disa aspekteve të strategjisë së energjisë me një shumë prej 8.5 milion USD³. Projekti PATEL do të ndihmojë Qeverinë e Kosovës të krijojë kornizën e cila i jep mundësi investitorëve strategjik e të kualifikuar për të investuar në termocentrale dhe miniera. Projekti në këtë kontekst synon të zhvillojë kuadro vendore për të miratuar dhe implementuar udhëzimet ndërkombëtare në lidhje me aspektet sociale, ekonomike dhe mjedisore të zhvillimit të sektorit. Grupi i Bankës Botërore (*origj. World Bank Group*) (Banka Botërore, KFN-ja, AGIM-i) përmes përkrahjes së kësaj strategjie luan rol shtytës në joshjen e investitorëve strategjik privat të nivelit botëror për të zhvilluar dhe shfrytëzuar resurset e linjit në Kosovë në mënyrë transparente, të qëndrueshme në aspektin mjedisor dhe social dhe me përgjegjësi fiskale. PATEL vepron duke u bazuar në projektet paraprake dhe të vazhdueshme të asistencës teknike në Sektorin e Energjisë në Kosovë (ESTAP I, II dhe III) dhe asistencën teknike dhe financiare të KE-së për rehabilitimin e termocentraleve. Ky grant është plotësuar me një grant tjetër të dytë (Projekti për pastrimin dhe rikoperimin e tokës – PPRT i cili do të bashkëfinancohet përmes përkrahjes bilaterale të donatorëve të tjerë), që përkrah pilot projektin për rikoperimin e tokës pas periudhës së mihjes i cili do të zhvillojë kuadro të zyrtarëve të mjedisit në këtë lëmi përmes përvojës, duke e bërë tokën të jetë në dispozicion për shfrytëzime të tjera alternative.

3.1.5 Struktura menaxhuese e projektit për projektin ATEL

Struktura menaxhuese e projektit është si në vijim:

- Organi ndërmënytor dhe ndërinstitucional i quajtur Komisioni drejtues i projektit (KDP)⁴ është organi më i lartë vendimmarrës dhe ekzekutiv i projektit, i cili është themeluar në bazë të Vendimit ekzekutiv nr. 2006/6 i lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 17 mars 2006 me qëllim të përkrahjes së

³ Marrëveshja për financim (Projekti i asistencës teknike për energji nga linjiti) ndërmjet MISIONIT TË ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË dhe ASOCIACIONIT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR

⁴ Vendimi Ekzekutiv nr. 2006/6 i datës 17 mars 2006 i PSSP-së në bazë të cilit është krijuar Komisioni drejtues i projektit dhe zyra e projektit, ka kaluar nëpër ndryshime, pezullime, anulime, shfuqizime ose nëpër heqje që ka ndikuar materialisht dhe në mënyrë të disfavorshme në kapacitetin e KDP-së dhe/ose ZP-së për të kryer obligimet, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre që i kanë në lidhje me projektin. Në këtë mënyrë për Komisionin drejtues të projektit është shfuqizuar një pjesë e Kapitullit 8 të Ligjit nr. 2004/9 për Zyrën e Rregullatorit për Energji të Kosovës.


menaxhimit dhe mbikëqyrjes, për të siguruar implementim efektiv të Projektit ATEL, si dhe në rast nevojë për intervenime në nivel politik;

- Zyra e Projektit është vartëse e MEM-it dhe gjendet në MEM. Shih fig. 3.1.

KDP-ja është themeluar dhe gjatë tërë kohës së implementimit të projektit funksionon në njëjtën përbërje, të njëjtat burime, detyra dhe përgjegjësi të caktuara. Përfaqësimi në KDP është definuar në atë mënyrë që të sigurojë pjesëmarrjen e të gjitha ministrive dhe agjencive kyçe të cilat kanë përgjegjësi për një apo më shumë aspekte të projektit që implementohet. Përfaqësuesit sigurojnë që në mbledhje të KDP-së do të marrin pjesë stafi përkatës nga ministria ose agjencia. Komisioni drejtues i projektit (KDP) kryesohet nga ministri i Energjisë dhe Minierave ose nga një person i caktuar nga ai dhe përbëhet nga nëntë (9) anëtarë tjerë që përfaqësojnë Zyrën e PSSP-së, Shefin e Shtyllës së IV-të të UNMIK-ut, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF-it), Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), dhe Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Katër anëtarët e obligueshëm (të cilët kanë mundësinë e vetos gjatë votimit) janë MEM-i, MMPH-ja, ZRRE-ja dhe KPM.

Struktura përfaqësuese në KDP është dizajnuar për të siguruar pjesëmarrje të plotë nga ministrinë dhe agjencitë qeveritare të cilat kanë përgjegjësi në njërën nga domenet që synohen nga projekti. Të gjitha këto institucione dhe subjekte qeveritare janë përgjegjëse për propozimin e kandidatëve të duhur nga stafi i tyre për KDP. KDP-ja do të jetë përgjegjëse për bashkërendimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e funksionimit të duhur të Zyrës së projektit në mënyrë që të siguroj implementim të duhur dhe harmoni me kërkesat e Bankës. KDP-ja si organ ndërministror dhe ndërinstitutional do të jetë i shumëllojshëm në aspektin e historikut, njohurive, përvojave dhe profesioneve. Kryesuesi sipas nevojës bën thirrjen e mbledhjes së KDP-së. KDP-ja për të kryer funksionet e saj do të takohet në seancat punuese mujore dhe sa herë që është e nevojshme. Në seancën e KDP-së ose në mbledhje tjera do të miratohet vendime të cilat arrihen me konsensus ndërmjet MEM-it, MMPH-së, KPM-së dhe ZRRE-së.

Figura 3.3



3.1.6 Objektivat e projektit PATEL dhe përmbledhja e komponenteve – implementimi

Objektivat e PATEL-it janë:

- Të ndihmojë IPVQ-të të përforcojnë kornizat politike, ligjore dhe rregullative të favorshme për investime të reja në Sektorin e energjisë; zhvillimin e instrumenteve të ndryshme politike, ligjore dhe rregullave në energjetikë në harmoni me praktikën e mira ndërkombëtare dhe zhvillimin e asistencës teknike për organizimin e ofertimit dhe negociatave të cilat rezultojnë me përmbyllje financiare në sektorin e ri të investimeve;
- Të ndihmojë IPVQ-të në një pilot transaksion për joshjen e investimeve private për ndërtimin e një kapacitetit të ri për gjenerim të energjisë me linjit, të udhëhequra nga parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale;

3.2 Shprehja e interesit (ShI) dhe lista e shkurtër e ofertuesve të kualifikuar (kriteret, lista)

KDP-ja menjëherë pas themelimit, më datën 15 gusht 2006, lëshojë një ftesë në nivel ndërkombëtar për shprehje të interesit (ShI) nga ofertuesit e kualifikuar të cilët kanë dëshirë të marrin pjesë në një projekt privat për zhvillimin e një kompleksi të ri për mihje të thëngjillit dhe kapacitetin shoqërues të gjenerimit dhe transmisionit të energjisë elektrike, si dhe rehabilitimin e gjeneratorëve ekzistues (tash e tutje njihet si "Projekti"). Projekti ka këtë komponentë:

- ndërtimin e një termocentrali të ri "Kosova C" ("TC C") me një kapacitet deri në 2100 MW dhe me kapacitetin përkatës të transmisionit;
- zhvillimi i një miniere të re të linjtit për njësitë ekzistuese të gjenerimit ("Sibovc JP") dhe zhvillimin e një miniere të re (Miniera e Sibovcit) për TC-në; dhe
- rehabilitimin e disa njësive të caktuara të termocentralit ekzistues "Kosova A" ("TC A").

Ftesa e nivelit ndërkombëtar për ShI ka pasuar me një konferencë ndërkombëtare të investitorëve e cila është mbajtur në Prishtinë, më 10 dhe 11 tetor 2006. Konferenca është mbajtur me sukses të madh pasi që në lidhje me të kanë shprehur interesin dhe kanë marrë pjesë një numër i zhvilluesve të rëndësishëm të kompanive të rëndësishme dhe projekteve private për energji.

KDP-ja pas Konferencës ndërkombëtare të investitorëve përgatiti dhe ua shpërndau 10 konzorciumeve/kompanive të cilat iu përgjigjen ftesës për ShI katër kritere të kualifikueshmërsisë për "parakualifikimin e ofertuesve". Këto katër kritere ishin:

Ofertuesit potencial duhet të përmbushin kriteret minimale të dhëna në vijim:

- ka zhvilluar projekte për gjenerim të energjisë elektrike me anë të fushave të gjelbërta, thëngjill apo linjit që kanë një total më shumë se 2500 MW, e të cilat janë ose në ndërtim e sipër ose në funksion;
- ka siguruar më shumë se 2 miliardë euro të borxhit për projekte të kufizuara mbështetëse ose përmes financimit afatgjatë korporativ deri më 30 nëntor 2006 në Sektorin e energjisë ose minierave ose ka pasur së paku 2 miliardë euro rezerva të lira të parave të gatshme të raportuara në pasqyrat e audituara financiare të vitit 2005;
- deri më 30 nëntor 2006 ka zhvilluar apo ka vënë në funksionim miniera të cilat prodhojnë linjit ose thëngjill me më shumë se 20 miliona tona në vit;
- deri më 30 nëntor 2006 ka pasur kontroll mbi apo operon një apo më shumë kompani dhe/ose forma koncesioni për gjenerimin e energjisë me një kapacitet total prej së paku 10000 MW.

Si rezultat kemi pasur katër konzorciume të mëdha ndërkombëtare (30 dhjetor 2006) të cilat plotësojnë këto katër kritere dhe si pasojë janë vënë në listën e shkurtër si "ofertues të kualifikuar" për përfshirje në procesin e mëtuqjeshëm. Këto konzorciume janë:

- a. RWE Power AG (Gjermani)
- b. EnBW dhe Washington Group International (Gjermani/ShBA)
- c. CEZ dhe AES (Çeki/ShBA)
- d. ENEL dhe SENCAP (PPC) (Itali/Greqi/ShBA)

Të gjithë ofertuesit e mundshëm para dorëzimit të kërkesës për parakualifikim kanë emëruar një përfaqësues dhe një zëvendësues, ku janë dhënë adresa, numri i telefonit dhe faksit, për pranimin e njoftimeve dhe komunikimeve tjera në lidhje me kërkesën e tyre. Përfaqësuesit e tillë mund të ndërrohen nga ofertuesi i mundshëm me atë të njoftimit dërguar MEM-it. Ofertuesit e mundshëm kanë marrë pjesë në proces vetëm pas pagesës së tarifës për hulumtime paraprake.

3.3 Fushëveprimi i këshilltarëve teknik

KDP në të njëjtën kohë ka vazhduar me prokurimin e shërbimeve konsulentë për:

- Shërbime këshillëdhënëse për transaksione;
- Shërbime për këshillime ligjore;

- Shërbime këshillëdhënëse për ruajtësit social dhe mjedisor;

Puna e konsulentëve do të financohet përmes një granti i cili i është dhënë klientit nga Banka Botërore.

Këshilltari më i rëndësishëm në proces është këshilltari për transaksione pasi që i njëjti duhet që:

Qëllimi

Të ofrojë shërbime këshilluese për transaksione dhe të ndihmojë KDP-në e PATEL-it në joshjen e pjesëmarrjes së sektorit privat

Fushëveprimi (në tri faza):

Faza 1: Puna përgatitore

- shqyrtimi i strukturës së tregut dhe ndërmarrja e masave (strukture, ligjore, mjedisore, etj) për të lehtësuar apo mundësuar kryerjen e transaksioni;
- përgatitja e pakos përfundimtare të investimeve (bazuar në Analizën e Opsioneve) dhe dhënien e rekomandimit në lidhje me listën e shkurtër të ofertuesve të kualifikuar.


Faza 2: Përgatitja e kërkesave për propozime (KPK) dhe ofertim:

- përgatitja e dokumenteve të nevojshme për ndërmarrjen e një procesi transparent dhe konkurrues të ofertimit – lëshimi i KPK për ofertuesit të përfshirë në listën e shkurtër të aprovuar.

Faza 3: Negociatat dhe mbyllja:

- asistencë në përfundimin e negociatave me ofertuesin e suksesshëm në lidhje me kushtet dhe afatet e pranuar në mënyrë reciproke (në bashkëpunim të ngushtë me Këshilltarët për çështje ligjore).

KDP-ja ka miratuar disa dokumente, siç janë: manuali i punës (Operimit) (OM), kodi i sjelljes dhe kodi i etikës, etj. Në MO paraqiten parimet, procedurat dhe rregullat për implementimin e asistencës teknike për energji nga linjiti duke shtruar bazën dhe përdorë lidhje me një varg dokumentesh tjera parësore siç janë: marrëveshja për financim dhe dokumenti i vlerësimit të projektit (DVP), plani vjetor i punës i cili rrjedh nga plani për implementimin e projektit, udhëzimet e Bankës Botërore në lidhje me prokurimet e financuara përmes huave të BNRZh-së dhe ANZh-së, lëshim i muajit maj 2004, etj. Kodi i sjelljes dhe kodi i etikës ka për qëllim të jetë si udhëzues i përfaqësuesve të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Komisionit të projektit PATEL (KDP) dhe Zyrës së projektit (ZP) të cilët marrin pjesë në procesin e biznesit i cili ka si element aktivitetin e prokurimit, në çfarëdo faze dhe çfarëdo niveli të inputeve, drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë.

Tabela 3.2. Afati kohor për implementimin e projektit

3.4 Studimet për përkrahjen e zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe transmissioinit përkatës

Agjencia Evropiane për Rindërtim dhe Konzorciumi më 13 dhjetor 2004 emëruan Konsulentë për kryerjen e studimeve teknike dhe ekonomike për përkrahjen e "zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe transmissioinit përkatës". Data e fillimit të këtij projekti është caktuar të jetë 15 janar 2007. Studimet të cilat duhet të bëhen nga konsulenti do të shërbejnë si material bazë ose përkrahje për punën e këshilltarëve për transaksion në përzgjedhjen e investitorit për kapacitetin rigjenerues.

Detyrat e para kanë të bëjnë me identifikimin e shfrytëzuesve potencial të energjisë elektrike dhe parashikimeve të kërkesës në EJT. Në këtë detyrë përfshihet edhe caktimi i çmimeve të tregut. Si skenar kryesor Konzorciumi ka zgjedhur skenarin 5 të studimit rajonal SIGj me kosto më të ulët të investimit dhe versionin më të ri nga SEEC dhe versionin më të hershëm të SIGj-it për SIRB. Ky skenar paraqet zhvillimin e prituri të parkut të termocentraleve në EJT duke u bazuar në supozimet e mëposhtme:

- mesataren e rritjes së kërkesës;
- mesataren e çmimit të derivateve;
- shpenzimi në lidhje me CO₂ që është 20 euro për ton të CO₂;
- program i arsyetuar i rehabilitimit.

Ky skenar është përzgjedhur si kryesor pasi që nuk është konsideruar si e drejtë që të bëhet llogaritja e të ardhmes pa marrë parasysh ngarkesat për CO₂ në EJT edhe pse rregulloret në lidhje

me uljen e emetimit të CO₂ në EJT pas vitit 2012 mbartin nivel shumë të lartë të paqartësisë. Detyra e dytë ka të bëjë me sistemin e transmissioinit dhe mënyrën si të trajtohet dhe eksportohet kapaciteti i ri gjenerues. Një çështje tjetër e rëndësishme është edhe madhësia maksimale e njësisë e cila mund të lidhet në mënyrë të sigurt me sistemin e transmissioinit në EJT. Madhësia e njësisë dhe teknologjia e termocentralit do të zhvillohet bazuar në rezultatet e studimit të tregut dhe transmissioinit (tri alternativa). Qëndrueshmëria e tyre ekonomike dhe financiare është vendosur përmes një modeli financiar i cili do të zhvillohet gjatë procesit të punës. Pastaj ky model do të mund të shfrytëzohet për të testuar struktura të ndryshme financiare/kontraktuale të kapacitetit të ri gjenerues. Gjithashtu do të mbahet edhe një mbledhje dhe do të bëhet një analizë ekstensive e të dhënave mjedisore me qëllim të ekzaminimit të vendndodhjeve të mundshme të termocentralit, si dhe për të siguruar bazën për punën e ardhshme dhe studimet EIA në lidhje me termocentralin e ri.

KAPITULLI 4

SHQYRTIMI I PARË I ÇMIMEVE NË SEKTORIN E ENERGJISË

(PËR PERIUDHËN RREGULLATIVE 2007-2009)

4.1 Historiku

Në muajin mars 2006, ZRRE-ja inicioj shqyrtimin e parë të tarifave të energjisë elektrike që nga viti 2000 dhe hera e parë është që ZRRE-ja ka ushtruar kompetencat e veta për shqyrtimin dhe miratimin e tarifave të energjisë elektrike.

Shqyrtimi është bazuar në procesin e tarifave sipas punës, ashtu siç është përcaktuar në Rregullën e ZRRE-së mbi parimet e llogaritjes së tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike ("Rregulla e çmimeve") dhe Metodologjia e tarifave⁵. Sipas kësaj qasjeje, ZRRE-ja fillimisht përcakton të hyrat e lejuara të cilat duhet të përmirësohen nga tarifat e rregulluara në secilin vit dhe për secilën licencë. Të licencuarit pastaj aplikojnë në ZRRE për miratimin e tarifave të cilat i mbulojnë këto të hyra të lejuara.

Tarifat e rregulluara dhe të miratuara nga ZRRE-ja përbëhen nga:

- **çmimet të cilat zbatohen nga KOSTT Sh.A. për shfrytëzimin e sistemit për transimion (TUOS), sistemi operator (SO) dhe operator tregu(OT).** Pagesat ShST zbatohen për të gjithë furnizuesit e konsumatorëve në Kosovë, mirëpo nuk zbatohen për gjeneruesit. Pagesa SO dhe OT zbatohen edhe për furnizuesit dhe gjeneruesit dhe përfshinë koston e shërbimeve ndihmëse të prokuruar brenda dhe jashtë Kosovës. Për energjinë elektrike e cila kalon transit në Kosovë nuk zbatohet asnjë pagesë, kështu që në vend të kësaj për energjinë e tillë duhet paguar çmimi për shfrytëzimin e rrjeteve të Kosovës, në pajtim me metodologjinë e OSTE/OSTEJL dhe rregulloren 1228/03/EC për skemën e kompensimit ndërmjet OST (KNOST);
- **tarifat me pakicë që u ngarkohen konsumatorëve të pa privilegjuar nga biznesi i licencuar i KEK Sh.A. për furnizim publik ("KEK - furnizuesi publik").** Këto tarifa përbëhen nga kostoja e blerjes së energjisë elektrike (nga gjeneruesit në Kosovë dhe nga importet), pagesat e KEK Sh.A. për KOSTT, kostot e biznesit të licencuar të KEK Sh.A për shpërndarje dhe lejimi për kostot e KEK - furnizuesi publik;

Me qëllime të përcaktimit të tarifave të rregulluara me pakicë, ZRRE-ja është e obliguar t'i përcaktojë të hyrat e lejuara të cilat duhet të rikthehen nga konsumatorët të pa privilegjuar për:

⁵ Këto dokumente mund të gjenden në uebfaqen e ZRRE-së.

- aktivitetin e KEK Sh.A. për mihje, i cili shërben për furnizimin e gjeneratorëve të KEK Sh.A;
- aktivitetin e licencuar i KEK Sh.A. për gjenerim (i cili ka në pronësi dhe operon me Kosovën A dhe Kosovën B);
- shpërndarësin e KEK-ut.

ZRRE-ja si shtesë duhet të bëjë supozime në lidhje me kostot e energjisë së importuar nga KEK - furnizuesi publik, të hyrat nga eksporti i energjisë elektrike, të cilat ulin të ardhurat e nevojshme për gjenerimin e KEK-ut që duhet të sigurohen nga konsumatorët e Kosovës dhe kostot e blerjeve të energjisë elektrike nga gjeneruesit e ndryshëm që gjenden në Kosovë e të cilët janë pjesë e KEK-ut.

Pagesat ndërmjet bizneseve të ndryshme të licencuara të KEK Sh.A. aktualisht trajtohen si transferime të brendshme. Me fillimin e tregut për shitje të përkohshme me shumicë, gjenerimi i KEK-ut dhe gjeneruesit tjerë do të nxjerrin të ardhura nga shitjet që bëhen sipas KBEE-ve dhe faturave dhe të cilat paguhen përmes mekanizmave të krijuar me rregullat e tregut. Ngarkesat që zbatohen nga gjenerimi i KEK-ut për shitjet që ia bën furnizimit publik të KEK-ut do t'i nënshtrohen miratimit nga ana e ZRRE-së. Qëllimi i ZRRE-së për një të ardhme të afërt gjithashtu është miratimi i ngarkesave/çmimeve të veçanta të cilat do të zbatohen nga Distribucioni i KEK-ut⁶.

4.2 Parimet

Parimet të cilat qeverisin tarifat e rregulluara janë të dhëna në nenin 46 dhe 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (nr. 2004/09, i shpallur më 30 qershor 2004). Këto parime janë përmirësuar dhe zhvilluar edhe më tutje në Rregullën për çmime dhe metodologjinë e tarifave që janë lëshuar nga ZRRE-ja.

Ndër parimet më të rëndësishme të përcaktuara në Ligjin për rregullatorin e energjisë janë:

- çmimet do të jenë të arsyeshme, jodiskriminuese, bazuar në kritere objektive dhe të përcaktuara në mënyrë transparente;
- çmimet kryesisht do të varen nga kostot e arsyetuara;
- në çmime do të merren parasysh edhe mbrojtja e mjedisit dhe konsumatorëve;
- çmimet për grupet individuale të konsumatorëve do të jenë në harmoni me koston e dërgimit të energjisë tek ata konsumatorë;
- nuk lejohet subvencionimi i ndërthurtë⁷ i kategorive të konsumatorëve;
- nuk do të lejohet subvencionimi i ndërmarrjeve të integruara;

⁶ Aktualisht asnjë konsumator i privilegjuar nuk është i kyçur në rrjetin e distribucionit. Prandaj, vonesat në miratimin e çmimeve të Distribucionit të KEK-ut nuk ka ndikim në konkurrencën që ekziston në tregun e energjisë elektrike pasi që asnjë furnizues konkurrent nuk kërkon qasje në këtë rrjet.

⁷ Subvencioni i ndërthurtë ekziston në rastet kur çmimet për një grup konsumatorësh janë më të ulta se sa kostoja e furnizimit të tyre, ndërsa ndryshimi ndërmjet asaj kostoje dhe çmimit kompensohet duke ngarkuar grupin tjetër të konsumatorëve me çmime më të larta se sa kostoja e furnizimit.

- normat sezonale dhe kohës së shfrytëzimit lejohen, kur normat e tilla kanë çmime të cilat rregullohen sipas kostos së periudhave të pikut dhe periudhave tjera.

ZRRE-ja në kohën e vështirësive ekonomike me të cilat përballet Kosova ka interpretuar detyrat e saj për mbrojtjen e konsumatorëve, përfshirë këtu:

- shmangien nga ngritjet e mëdha të çmimeve për konsumatorët që kanë nivel më të ulët të konsumit (e të cilët supozohet se në këtë grup konsumatorësh përfshihen familjet me të ardhura të ulëta);
- shmangien e tronditjeve me çmimeve të larta për grupet e konsumatorëve individual dhe në vend të kësaj lejon rregullimin gradual të tarifave në të cilat reflektohet kostoja.

ZRRE-ja gjatë procesit të përgatitjes së metodologjisë së tarifave ka miratuar edhe një numër të parimeve kyçe, të cilat janë konsultuar publikisht në kohën e miratimit të tyre dhe të cilat janë të reflektuara në metodologji, të ardhurat finale të lejuara dhe në tarifat e miratuara.

Pasi që KOSTT Sh.A. dhe KEK Sh.A. aktualisht nuk kanë kosto të financimit të ndërlidhura me pasuritë që i kanë që nga periudha para vitit 2006 atëherë nuk lejohet asnjë kthim në këto pasuri. Megjithatë, KOSTT Sh.A. dhe KEK Sh.A. pranojnë një shtesë ku reflektohen kostot e mbajtjes së gjendjes së këtyre pasurive. Në rast se pas zgjidhjes së statusit përfundimtar, KOSTT Sh.A. dhe KEK Sh.A. bëhen përgjegjëse për kthimin e borxheve ose për kosto tjera të ndërlidhura me këto pasur, atëherë ZRRE-ja do të lejoi që këto kosto të mbulohen përmes konsumatorëve.

- **KOSTT dhe Distribucioni i KEK-ut janë përgjegjës për koston e energjisë së blerë për mbulimin e humbjeve të transmisionit dhe distribucionit⁸.** Ata lejohen të bartin këtë përmes shtesës për këto kosto, bazuar në nivelin e synuar të humbjeve të përcaktuar nga ZRRE-ja dhe të mbajnë kursimet nga çfarëdo ulje të humbjeve nën këtë nivel (ose të paguajnë kostot shtesë për çfarëdo humbje shtesë), e në këtë mënyrë përballen me një stimulim të fuqishëm për zbritjen e humbjeve.
- **KOSTT Sh.A. dhe KEK Sh.A. nuk kanë kthime nga pasuritë e reja të cilat supozohen të financohen nga grantet e donatorëve ose nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK).** Nxjerrët një shtesë për zhvlerësim. Sa i përket pasurive që nuk janë financuar nga donatorët ose BKK-ja, nxjerrët një kthim komercial dhe supozimi i dhënë është që këto financime të bëhen përmes një kombinimi të fitimeve të mbajtura dhe huave të reja.

Siç dihet, niveli i arkëtimit të të hyrave të faturuara nga KEK Sh.A. është shumë i ulët. Shkalla e arkëtimit në vitin 2006 ka qenë rreth 65%. Sa për krahasim shkalla e arkëtimit në Bosnje dhe Hercegovinë raportohet⁹ të jetë 85% për konsumatorët industrial dhe 96% për amvisëritë, në Maqedoni shkalla e tillë është 73% për konsumatorët industrial dhe 82% për amvisëritë dhe në Serbi 87% për konsumatorët industrial dhe 93% për amvisëritë. Përkundër faktit që KEK Sh.A.

⁸ Dallimi ndërmjet energjisë së matur e cila hyn dhe del nga sistemi. Këto humbje përfshijnë vjedhjen e energjisë elektrike, mirëpo përjashtojnë energjinë e faturua e cila nuk është paguar (humbjet e arkëtimit).

⁹ Të dhënat nga të gjithë shembujt e dhënë nga Këshilli i rregullatorëve evropian për energji (11 maj 2006), *Pikat krahasuese për tarifa*, Projekti për përkrahjen e tregut regjional të energjisë elektrike në Evropën Juglindore (CO6-SEE-15-04). Të dhënat janë nga vitet e fundit të cilat janë në dispozicion (2004 ose 2005).

përballet me vështirësi të mëdha në rritjen e shkallës së arkëtimit, ekziston qartë një përmirësim thelbësor.

ZRRE-ja duke u bazuar në parimin e ekuitetit vendosi se nuk duhet të pritët që nga konsumatorët që paguajnë me rregull të mbulohen humbjet të cilat rezultojnë nga dështimi i KEK Sh.A. për arkëtimin e të ardhurave nga konsumatorët tjerë. Prandaj me rastin e shqyrtimit nuk është bërë asnjë shtesë për borxhet e këqija ose të ardhurat e faturuara, por të paarkëtuara. Kjo shërben si stimulim i fortë për KEK Sh.A. për rritjen e shkallës së arkëtimit. Gjithashtu me këtë hiqet nevoja për ngritjen e tarifave për mbulimin e shumave të paarkëtuara e cila do ta ndihmon realizueshmërinë.

ZRRE-ja në fund ka shpreh përkrahjen e saj për shfrytëzimin e periudhave shumëvjeçare për kontrollimin e çmimeve (p.sh. fiksimit e të hyrave të lejuara për një numër vitesh), aty ku është e mundshme në mënyrë që të shtohen stimulimet për të licencuarit për përmirësimin e efikasitetit të tyre dhe sigurimin e një stabiliteti dhe parashikueshmërie më të madhe të tarifave. Megjithatë, ZRRE-ja në qasje të këtill ka marrë parasysh vështirësitë mjedisore ku ekziston pasiguri e madhe e kërkesës për energji në të ardhmen, furnizimet që do të jenë në dispozicion nga gjeneratorët e KEK-ut, çmimet dhe sasia e cila do të jetë në dispozicion nga importet. Prandaj, ZRRE-ja në lidhje me shfrytëzimin e periudhave shumëvjeçare të kontrollit të çmimeve ka miratuar parimet në vijim:

- **kostoja e operimit, mirëmbajtjes dhe investimeve në rrjetin e transmisionit të KOSTT Sh.A. dhe rrjetin e Distribucionit të KEK-ut për periudhën trevjeçare është fikse (2007-09).** Kostot e lejuara të Distribucionit të KEK-ut janë të indeksuara pjesërisht me ndryshimet e kërkesës dhe të dy grupet e kostove janë të indeksuara me inflacion (duke përfshirë indeksin e harmonizuar të çmimit të konsumatorit në BE);
- **të gjitha kostot tjera të lejuara, përfshirë këtu edhe koston e KOSTT Sh.A. dhe Distribucionit të KEK-ut për humbjet në blerje, caktohen për çdo vit.** Megjithatë, për të lehtësuar planifikimin paraprak nga industria dhe konsumatorët e saj, ZRRE-ja e publikon një shteg të çmimit për periudhë trevjeçare ku paraqiten të hyrat e lejuara e të projektuara deri në 2009.

4.3 Përmbledhja e procesit

4.3.1 Përcaktimi i të hyrave të lejuara

ZRRE-ja gjatë procesit të shqyrtimit është ndihmuar nga dy kompani të pavarura konsulentësh të financuara nga Banka Botërore dhe AER-i.

Ky përcaktim i të hyrave të lejuara është bazuar në përgjigjet ndaj kërkesave të përgatitura nga ZRRE-ja dhe konsulentët e të cilat i janë dërguar të licencuarve. Përgjigjet të cilat janë pranuar i janë nënshtruar një analize të hollësishme e cila ka përfshirë krahasimin e kostove me pikat krahasuese ndërkombëtare dhe shqyrtimin e supozimeve së bashku me të licencuarit, Ministrinë e Energjisë dhe Minierave (MEM), Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF) dhe Zyrën për çështje fiskale të UNMIK-ut (ZÇF).

Ky proces, e në veçanti arritja e marrëveshjes për supozimet në lidhje me subvencionet që do të jenë në dispozicion të industrisë në të ardhmen, ka zgjatur më shumë se sa që është pritur dhe ka rezultuar me vonesa në miratimin e të hyrave të lejuara nga koha e cila fillimisht është synuar shtator - dhjetor 2006. Të hyrat e lejuara përfundimtare janë miratuar më 21 dhjetor 2006 (Vendimi D_29_2006¹⁰).

4.3.2 Miratimi i tarifave të rregulluara

Duke përdorur të hyrat e lejuara dhe aprovuara, ZRRE-ja dhe konsulentët kanë përgatitur tarifa indikativë për energjinë me pakicë për transimion dhe të njëjtat ia kanë dhënë të licencuarve si përkrahje për kërkesat e tyre në lidhje me miratimin e tarifave të reja. Kërkesat nga ZRRE-ja është dashur të pranohen për shqyrtim në fillim të vitit 2007.

ZRRE-ja duke pasur parasysh vonesat në miratimin e të hyrave të lejuara ka vendosur që tarifat e reja të hyjnë në fuqi më 1 prill 2007, dhe të zbatohen deri më 31 dhjetor 2007. Shuma e të hyrave të mbledhura sipas tarifave ekzistuese në tre muajt e parë të vitit në bazë të tarifave të reja gjatë pjesës tjetër të vitit duhet të jenë të barabarta me totalin e të ardhurave të lejuara të miratuara nga ZRRE-ja.

Shqyrtimi dhe miratimi i tarifave të reja nuk është përfshirë në Raportin Vjetor për vitin 2006 pasi që një gjë e tillë do të bëhet në vitin 2007.

4.3.3 Orari

Shqyrtimi i çmimeve me njoftim publik ka filluar më 8 mars 2006. Data kyçe e procesit të shqyrtimit dhe miratimit deri në vitin 2006 përfshinë:

më 14 mars 2006	publikimin e njoftimit për shqyrtimin e çmimeve;
më 26 maj 2006	tryezën e punës në lidhje me të dhënat e nevojshme dhe orarin;
më 10 qershor 2006	pranimin e të dhënave fillestare të dorëzuara nga KOSTT Sh.A. dhe KEK Sh.A.;
qershor - shtator 2006	shqyrtimin dhe analizimin e të dhënave të dorëzuara;
më 28 korrik 2006	publikimin e koston së propozuar të kapitalit (kthimet e lejuara) për KEK Sh.A. dhe KOSTT Sh.A. për komente;
më 30 korrik 2006	mbledhje pune publike lidhur me rregullimet e propozuara për kategoritë e konsumatorëve dhe strukturat e tarifave;
më 12 shtator 2006	mbledhje pune publike në lidhje me propozimin e të hyrave të lejuara për KEK Sh.A. dhe KOSTT Sh.A.;
më 20 shtator 2006	vendimi i Bordit të ZRRE-së për miratimin e koston së kapitalit që përdoret për përcaktimin e të ardhurave të lejuara;

¹⁰ Publikuar në uebfaqen e ZRRE-së

tetor - nëntor 2006	konsultimet me hisedarët lidhur me propozimin për të ardhurat e lejuara, përfshirë këtu KEK Sh.A., KOSTT Sh.A., MEM, MEF dhe ZÇF;
më 24 nëntor 2006	miratimin e përkohshëm nga Bordi i ZRrE-së për të ardhurat e lejuara nga KEK Sh.A. dhe KOSTT Sh.A. dhe publikimi i tyre për komentime, pasi që afati për dhënien e komenteve ka qenë më datë 4 dhjetor 2006;
më 21 dhjetor 2006	vendimi i Bordit të ZRRE-së për miratimin e të ardhurave të lejuara të KEK Sh.A. dhe KOSTT Sh.A.

ZRRE-ja gjatë procesit të shqyrtimit theks të veçantë i ka dhënë rëndësisë së konsultimeve publike. Këtu është përfshirë edhe publikimi i dokumenteve kyçe në uebfaqe, mbajtja e mbledhjeve publike dhe diskutimet e drejtpërdrejta me hisedarët, përfshirë këtu të licencuarit, përfaqësuesit e Qeverisë dhe të Parlamentit.

4.3.4 Rezultatet

Të ardhurat e lejuara dhe të miratuara përfundimtare nga ZRRE-ja më 21 dhjetor 2006 janë si në vijim.

Tabela 4.1 Të ardhurat e lejuara të miratuara


	Të miratuara	Parashikimi	
	2007 €000	2008 €000	2009 €000
KEK - Furnizuesi Publik (të ardhurat nga tarifat e rregulluara për energji me pakicë)	141,899	148,796	158,690
KOSTT Sh.A.(të ardhurat nga pagesat për transmision)	13,678	17,026	21,765

Nëse supozojmë se kërkesa për vitin 2007 do të jetë e barabartë me nivelet e parashikuara, atëherë mesatarja e tarifës së rregulluar për energji me pakicë në vitin 2007 do të jetë 5.26 eurocent/kWh. Kjo paraqet një rritje prej 6.9%, nga mesatarja e tarifës së faturuar nga KEK-u në vitin 2006, që ishte 4.92 eurocent/kWh. Është me rëndësi të theksohet se për shkak të vonësës në zbatimin e tarifave të reja (të cilat do të fillojnë më 1 prill 2007) dhe rebalancimi i tarifave ekzistuese drejt një strukture e cila reflekton koston dhe eliminon subvencionet e ndërthurta ndërmjet konsumatorëve (siç kërkohet nga Ligji për Rregullatorin e Energjisë), nga kjo mesatare mund të lëvizë ndryshimi aktual i tarifave individuale.

Nëse i krahasojmë tarifat aktuale për ekonomitë familjare në Kosovë, me ato të vendeve tjera në Evropën Juglindore, atëherë gjejmë se tarifat e zbatuara përkohë me tarifat e ulëta të rajonit. Kjo do të mbetet kështu edhe pas zbatimit të rritjes së mesatares e cila është pasojë e të ardhurave të lejuara që janë miratuar nga ZRRE-ja. Një çështje e tillë do të ilustruhet më poshtë. Ndryshimi

aktual i tarifave për ekonomitë familjare sigurisht së do të varet nga ndryshimet përkatëse në strukturat e tarifave të propozuara nga të licencuarit dhe të shqyrtuara e miratuara nga ZRRE-ja.

Figura 4.1 Mesatarja e tarifave për amvisëritë në Evropën Juglindore



4.3.5 Burimet

UNMIK - KEK Sh.A. (totali i të ardhurave dhe energjisë faturuar konsumatorëve nga kategoria e amvisërive në vitin 2006)

Të tjera:

Këshilli i Rregullatorëve Evropian për Energji (11 maj 2006), caktimi i pikave krahasuese, projekti i përkrahjes teknike për sistemin e energjisë elektrike të Evropës Jugore. Të dhënat më të reja në dispozicion janë nga viti 2004 ose 2005.

KAPITULLI 5

MBROJTJA E KONSUMATORËVE

5.1 Numri dhe procesimi i ankesave

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin për Energji në seancën e mbajtur më 17 janar 2006 ka miratuar **Rregullën për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në sektorin e energjisë**.

Duke u bazuar në dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtë që të parashtrorjnë ankesa që kanë të bëjnë me shërbimet e ofruara nga furnizuesi ose operatori i sistemit të shpërndarjes. Ankesat e parashtruara, para dorëzimit në ZRRE-në, së pari duhet dorëzuar furnizuesit.

Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve (DMK) i ZRRE-së është përfshirë në këto detyra : mbrojtjen e konsumatorëve, analizimin e të dhënave marrë nga KEK-u, përqendrimin në ankesat e konsumatorëve, pjesëmarrjen në procedurat e shqyrtimit nga KEK-u në lidhje me: kyçjen, shlyerjen e borxheve, zgjidhjen e kontesteve, ngarkesave, gjobave, etj, për të siguruar se procedurat e propozuara nuk janë diskriminuese dhe të njëjtat të gjithë konsumatorët i trajtojnë në mënyrë të barabartë.

Më poshtë është dhënë një tabelë me të gjitha ankesat e regjistruara në Departamentin për kujdes ndaj konsumatorëve në KEK, dhe tabela me ankesat e zgjidhura për vitin 2006.

Tabela 5.1 Numri i ankesave të regjistruara në Departamentin për kujdes ndaj konsumatorëve të KEK-ut në vitin 2006

	Pagesë e paregjistruar	Bilanci filestar gabim	Mosmarrje e faturave	Mbilimti	Ndryshimi i paushallit	Lexim jokorrekt	Lexim jo i rregullt	Njëhësorë jo i saktë	Kërkesë për shlyrje të borxhit	Ngarkuar me TVSH	PEP	Të tjera	Gjithsejt
Janar	12	70	5	693	87	43	25	25	51	13	14	909	1947
Shkurt	12	49	2	854	177	72	691	42	59	2	22	1130	2608
Mars	23	64	5	869	193	62	247	27	110	3	21	1305	2929
Prill	14	52	3	972	184	68	445	55	61	2	13	1050	2919
Maj	18	67	0	755	153	91	254	11	55	3	17	928	2352
Qershor	9	25	0	311	59	37	55	15	48	0	1	486	1046
Korrik	8	5	3	215	47	35	42	8	22	0	10	180	575
Gusht	3	20	1	203	30	35	33	21	43	1	12	211	613
Shtator	13	40	3	311	98	57	41	16	62	1	6	681	1329
Tetor	10	57	22	422	71	47	100	17	74	1	3	836	1660
Nëntor	21	56	13	569	160	53	27	26	82	3	8	1051	2069
Dhjetor	5	59	1	381	46	28	20	20	46	0	11	694	1311
Total	148	564	58	6555	1305	628	1980	283	713	29	138	9461	21358

Mbilimti i paraqitur në tabelë nënkupton se konsumi i konsumatorëve mbi 800 KWh në sezona të ndryshme (sezona e lartë dhe e ulët) kalkulohet me çmime të ndryshme. Më saktësisht, çmimi për KWh mbi limitin 800 KWh është me i lartë se sa për konsumin nën 800 KWh. Gjithashtu duhet theksuar se kalkulimi për konsumin i mbilimit bëhet në mënyra të ndryshme nga kalkulimi i energjisë së paraqitur në faturë.

Figura 5.1 Prezantimi grafik i ankesave të regjistruara në Departamentin për kujdes ndaj konsumatorëve të KEK-ut në vitin 2006





Tabela 5.2 Numri i ankesave të zgjidhura nga Departamenti për kujdes ndaj konsumatorëve të KEK-ut në vitin 2006

	Pagesë e paregjistruar	Bilanci fillestar gabim	Mosmarrje e faturave	Mbilimiti	Ndryshimi i paushallit	Lexim jokorrek	Lexim jo i rregullt	Njehësorë jo i saktë	Kërkesë për shlyrje të borxhit	Ngarkuar me TVSH	PEP	Të tjera	Gjithsejt
Janar	10	56	0	553	80	51	22	15	45	13	14	781	1640
Shkurt	10	49	0	829	164	57	169	31	56	2	22	1052	2441
Mars	19	58	0	808	180	54	226	23	101	3	21	1107	2600
Prill	13	46	0	891	165	81	390	45	50	3	13	892	2589
Maj	15	58	0	700	147	83	232	11	49	3	17	812	2127
Qershor	3	2	0	213	9	9	32	10	5	0	0	64	347
Korrik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gusht	0	0	0	171	15	37	33	4	16	0	0	208	484
Shtator	2	6	0	189	54	17	26	4	13	0	0	402	713
Tetor	8	5	0	367	39	68	85	8	37	1	0	364	982
Nëntor	8	5	0	440	108	58	111	24	31	7	0	588	1380
Dhjetor	0	1	0	241	5	4	22	4	0	0	11	104	392
Total	88	286	0	5402	966	519	1348	179	403	32	98	6374	15695

Figura 5.2 Prezantimi grafik i ankesave të zgjidhura nga Departamenti për kujdes ndaj konsumatorëve të KEK-ut në vitin 2006



Departamenti për mbrojtje e konsumatorëve në ZRRE sipas dispozitave të Rregullës për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në Sektorin e energjisë gjatë periudhës janar 2006 - mars 2007 ka regjistruar 52 ankesa të konsumatorëve. Ankesat e konsumatorëve mund të kategorizohen si në vijim:

- 35 ankesa të konsumatorëve të regjistruara në DMK janë nga konsumatorët shtëpiak;
- 13 ankesa të konsumatorëve të regjistruara në DMK janë nga konsumatorët komercial;
- 4 ankesa të konsumatorëve të regjistruara në DMK janë nga konsumatorët industrial.

Më poshtë mund të shifet tabela e ankesave të regjistruara nga Departamenti për mbrojtje e konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007.

Tabela 5.3 Ankesat e regjistruara nga Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007.

	Shfrytëzim paautorizuar	Borxhi I mëparshëm	PEP	Mbilimiti	Maksigrafi	Faturimi pa matje - paushall	Gjobat shkycje	për Kompenzim	Të tjera	Gjithsejt
Janar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	0	0	2	0	1	0	0	0	1	4
Maj	1	0	1	0	0	0	0	0	0	2
Qershor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Korrik	0	2	0	1	1	0	1	0	0	5
Gusht	0	2	0	0	1	0	0	0	1	4
Shtator	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1
Tetor	0	1	0	1	0	0	1	1	2	6
Nëntor	2	0	0	0	0	1	0	0	1	4
Dhjetor	0	2	1	0	0	1	0	2	1	7
Janar	1	0	1	1	0	1	0	0	2	6
Shkurt	0	0	3	0	0	1	1	0	1	6
Mars	1	0	1	0	0	0	1	1	3	7
Total	5	7	9	3	3	4	4	4	13	52

Figura 5.3 Prezantimi grafik i ankesave të regjistruara nga Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007.





Tabela 5.4 Numri i ankesave të zgjidhura nga Departamentin për mbrojtje të konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007.

	Shfrytëzim paautorizuar	Borxhi I mëparshëm	PEP	Mbilimiti	Maksigrafi	Faturimi pa matje - paushall	Gjobat për shkycje	Kompensim	Të tjera	Gjithsejt
Janar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkurt	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	0	0	2	0	0	0	0	0	0	2
Qershor	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
Korrik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gusht	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Shtator	1	0	0	1	1	0	0	0	0	3
Tetor	0	2	0	0	0	0	0	0	0	2
Nëntor	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1
Dhjetor	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Janar	0	1	0	0	0	0	0	3	1	5
Shkurt	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	1	0	1	0	0	0	1	0	0	3
Total	3	4	4	2	1	0	1	3	1	19

Figura 5.4 Prezantimi grafik i ankesave të zgjidhura nga Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve (DMK) në ZRRE gjatë periudhës janar 2006 – mars 2007.



Nga 52 ankesa të konsumatorëve të regjistruara nga DMK në periudhën janar 2006 - mars 2007, 19 sosh janë zgjidhur sipas dispozitave të Rregullës për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në Sektorin e energjisë.

Ankesat e konsumatorëve që janë zgjidhur nga Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve në periudhën janar 2006 - mars 2007, ishin nga kategori të ndryshme të dhëna më poshtë:

- 13 ankesa të konsumatorëve të regjistruara në DMK janë nga konsumatorët shtëpiak;
- 4 ankesa të konsumatorëve të regjistruara në DMK janë nga konsumatorët komercial;
- 2 ankesa të konsumatorëve të regjistruara në DMK janë nga konsumatorët industrial.


Ankesat e regjistruara nga DMK-ja në periudhën janar 2006 deri në mars 2007, kanë qenë natyrave të ndryshme, si për shembull: lidhje me konsum të paautorizuar, borxhe paraprake, PBF (tatimi RTK), mbilimiti, maksigraf, kompensime për dëme, etj.

Në tabelën e poshtëshënuar krahasuese shifën ankesat e regjistruara dhe të zgjidhura nga Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve (DMK) në ZRRE, dhe grafikoni për periudhën janar 2006 – mars 2007.

Tabela 5.5 Krahasimi i ankesave të regjistruara dhe të zgjidhura, si dhe grafikoni për periudhën janar 2006 – mars 2007, nga Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve në ZRRE.

	Regjistruara	Zgjidhura
Janar	0	0
Shkurt	0	0
Mars	0	0
Prill	4	0
Maj	2	2
Qershor	0	1
Korrik	5	0
Gusht	4	1
Shtator	1	3
Tetor	6	2
Nëntor	4	1
Dhjetor	7	1
Janar	6	5
Shkurt	6	0
Mars	7	3
Gjithsej	52	19

Figura 5.5 Prezantimi grafik i krahasimit të ankesave të regjistruara dhe të zgjidhura, si dhe grafikoni për periudhën janar 2006 – mars 2007, nga Departamenti për mbrojtje të konsumatorëve në ZRRE.



Në periudhën janar 2006 - mars 2007 janë zgjidhur 19 ankesa të konsumatorëve nga 52 sa janë regjistruar në periudhën e njëjtë. Ankesat tjera të regjistruara në DMK dhe të pazgjidhura nënkuptojnë se ato ose janë në procedurën e zgjidhjes alternative të kontesteve (ZAK) bazuar në kapitullin 4 të Rregullës mbi procedurën e zgjidhjes së kontesteve në Sektorin e energjisë, ose janë ende në proces të zgjidhjes.

Prej 19 ankesave të zgjidhura konsumatorëve nga DMK-ja:

- 8 prej tyre janë refuzuar,
- 4 janë pranuar, dhe
- 7 sosh kanë pasur formën e informacioneve të drejtuara për konsumatorët.

Informata e cila i jepet konsumatorëve dhe është regjistruar në DMK, ka kuptimin se është e bazuar në nenin 32.1 të Rregullit për procedurën e zgjidhjes së kontesteve në Sektorin e energjisë. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) nuk ka kompetenca për kontestet para vitit 2004, andaj kontestët e para vitit 2005, pasi ta marrin përgjigjen e KEK-ut ,duhet t'i adresohen gjykatës..

5.2 Raporti i monitorimit të KEK-ut

Zyra e Rregullatorit të Energjisë me autoritetin e dhënë nga Ligji nr. 2004/09 për Rregullatorin e energjisë (neni 54), gjatë vitit 2006 (qershor) ka bërë monitorimin e KEK-ut me qëllim të stimulimit të performansës së KEK-ut. Qëllimi i monitorimit ka qenë që të bëhet vlerësimi i:

- implementimit të legjislacionit dytësor (rregullat, dekretet, kodet) miratuar nga ZRRE-ja;
- implementimit të vendimeve të lëshuara nga ZRRE-ja;
- efektët pozitive të ngritjes shkallës së faturimit dhe arkëtimit, përkatësisht uljes së humbjeve komerciale; dhe
- përmirësimit të marrëdhënieve me konsumatorë.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm ishte vlerësimi i njohurive dhe të kuptuarit e stafit të KEK-ut në lidhje me rregullat dytësore dhe vendimet e miratuara nga ZRRE-ja, dhënia e qartësimeve dhe zgjidhjes së problemeve eventuale gjatë fazës së implementimit.

ZRRE-ja ka bërë vlerësimin implementimin dhe fuqizimin e legjislacionit dytësor dhe dispozitave të vendimeve nga KEK-u. Ka bërë analizimin e rezultateve dhe ka përfunduar procesin duke dhënë udhëzime në lidhje me veprimet që duhet ndërmarrë në të ardhmen gjatë zbatimit të kornizës rregullative, që janë të nevojshme për rritjen e preferencave të konsumatorëve.

Raporti monitorues nuk ka pasur për qëllim vlerësimin e ndikimit të implementimit të kornizës rregullative në çështjen e humbjeve “joteknike” të energjisë, pasi që Rregulla për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji është miratuar më vonë dhe gjatë monitorimit rregulla si e tillë nuk është marrë parasysh. Megjithatë, analiza dhe vlerësimi i informatave dhe statistikave të pranuar e kanë shtyrë ZRRE-në të bëjë udhëzime të cilat mund të ndikojnë në përmirësimin e performansës së KEK-ut.

Sa i përket vendimeve të marra nga ZRRE-ja, gjatë procesit të monitorimit, vëmendje e veçantë i është kushtuar planit ABC të furnizimit. ZRRE-ja, bazuar në kërkesën zyrtare të KEK-ut ka shqyrtuar planin e furnizimit ABC dhe me anë të një vendimi (Vendimi D_08_2005 i datës 29 nëntor 2005) e ka miratuar të njëjtin. ZRRE-ja ka reaguar pozitivisht ndaj idesë për krijimin e një regjimi të furnizimit të ndryshueshëm, ku kriteri kryesor i ndryshueshmërisë së tillë ishte shkalla e arkëtimit, mirëpo e njëjta vendosi kushte të cilat kanë qasje dinamike dhe gjatë kohës mund të largojnë arsyet për zbatimin e reduktimeve. KEK-u ka dështuar në implementimin e kushteve të

vëna përmes vendimit të ZRRE-së dhe konsumatorët e rregullt të grupeve B dhe C kanë arsye të jenë të pakënaqur. Hollësitë në lidhje me dështimin e përmbushjes së kushteve, si shtesë ndaj planit ABC, janë në dispozicion në raportin monitorues i cili është publikuar në uebfaqen zyrtare të ZRRE-së. Gjatë periudhës së monitorimit dhe përmes kontrollimit të të dhënave statistikore është siguruar një bindje se implementimi i planit ABC është kryer me një disiplinë të kënaqshme. Mirëpo, në bazë të disa informatave të fundit (të cilat ende nuk janë verifikuar), është arritur në përfundim se stafi i KEK-ut ka filluar të dështojë në implementimin e drejtë të reduktimeve siç parashihet me plan. Ky problem do të shqyrtohet në veçanti në raportin e ardhshëm monitorues të ZRRE-së.

Gjatë procesit të implementimit dhe bazuar në intervistat që kemi pasur me stafin, janë identifikuar disa të gjetura në lidhje me statistikën dhe të dhënat e rezultateve lidhur me shkallën e arkëtimit të të hyrave, humbjeve, shkyçjeve, dhe kontesteve me konsumatorët, të cilat janë dhënë më poshtë:

- Për arritjen e rezultateve të kënaqshme dhe rritjen e shkallës së arkëtimit të të hyrave, si dhe për përmirësimin e kualitetit të shërbimeve të furnizimit me energji elektrike, nevojitet implementimi i menjëhershëm dhe në tërësi i legjislacionit dytësor;
- Implementimi i një ligji të caktuar kërkon përgatitjen e politikave dhe procedurave të brendshme përkatëse të korporatës të cilat duhet të pasojnë me një plan veprimi;
- Implementimi i pjesërisht (pavarësisht nëse ndërmerret nga subjektet e autorizuar që të bëjnë një gjë të tillë ose përmes një vendimi të brendshëm të marrë nga kompania) i çfarëdo rregulloreje ose vendimi, mund ta kompromentojë qëllimin e rregullores apo vendimit të tillë;
- Implementimi gjithëpërfshirës i politikës për shkyçje në periudhën e monitorimit pa implementimin e kërkesave për procedurat e zgjidhjes së kontesteve të miratuara nga ZRRE-ja, kushtet e politikës ABC, si dhe identifikimin i zgjidhjen së çështjes të vjedhjes së energjisë elektrike dhe ndërhyrjes në njëhisorë, nuk ka rezultuar me nivel të kënaqshëm të shkallës së arkëtimit të të hyrave përkundër faktit që numri i konsumatorëve të shkyçur ka qenë shumë i madh;

Veprimet e ndërmarra për ngritjen e shkallës së arkëtimit nuk kanë shtuar besimin e konsumatorëve ndaj KEK-ut, gjë që është dëshmuar me numrin në shtimin të konsumatorëve të rregullt të cilët janë prekur nga veprimet e shkyçjes.

Në bazë të rezultateve të gjetura janë nxjerrë konkludime si më poshtë:

Duke iu referuar rezultateve nga raporti i monitorimit, qëllimi i të cilit ka qenë vlerësimin i mënyrës dhe masës së implementimit të kornizës rregullative (kornizë e cila përpiket të krijoj kushte për arritjen e rezultateve më të mira dhe për të reflektuar shkallë më të lartë të arkëtimit), **ZRRE-ja mund të pohoj se janë bërë disa iniciativa elementare nga KEK-ut dhe një gjë e tillë është reflektuar në rezultatet fillestare;**

- Tanimë kur legjislacioni rregullativ është kompletuar dhe bazuar në faktin se ky legjislacion mbyll të gjitha proceset e relacionit ndërmjet shërbimit të ofruar dhe konsumatorit, është thelbësore që ky trend të mbahet deri në implementimin e plotë të tij;

- Intervistat me menaxherët ekzekutiv na tregojnë se korniza rregullative konsiderohet si një gjë e dobishme për përmirësimin e marrëdhënieve me konsumatorë që do të rezultonte me uljen e humbjeve komerciale dhe ngritjen e shkallës së arkëtimit të të hyrave. Implementimi i dispozitave të rregullave të lartpërmendura, sigurisht që do ta ulë shkallën e sjelljeve arbitrare kundruall konsumatorëve.

Duke u bazuar në të gjeturat dhe konkludimet e dhëna më lartë, Bordi i ZRRE-së ka lëshuar disa udhëzime për KEK-un, ku janë dhënë disa afate dhe veprime fillestare të KEK-ut ndërmarrja e të cilave është evidente, mirëpo situata e tanishme është larg rrugës për ndryshime të mëdha përmes implementimit të duhur të rregullave të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Raporti i monitorimit mund lexohet në www.ero-ks.org/Departments/Customer Protection.

KAPITULLI 6

NGROHJA QENDRORE

6.1 Pasqyrë e zhvillimeve në Sektorin e ngrohjes qendrore në vitin 2006

Ngrohja qendrore në Kosovë ende mbetet pa një zgjerim të dukshëm, por me një rritje të vogël në lidhje me kërkesën e vlerësuar për ngrohje në Kosovë e cila mbulon vetëm 5% të kërkesës totale. Sektori është i kufizuar vetëm në katër ndërmarrje të cilat mbulojnë Komunën e Prishtinës, Gjakovës, Mitrovicës dhe Zveçanit, të cilat pasuri gjenden nën përkujdesjen e AKM-së.

Pas përfundimit të procesit të korporatizimit deri në fund të vitit 2005 – transformimi në shoqëri aksionare, AKM-ja është aksionari i vetëm. Termokosi Sh.A. dhe Gjakova Sh.A. gjatë vitit 2006 janë përballur me disa detyra sfiduese për implementimin e qeverisjes korporative që parashihet në raportin përfundimtar të korporatizimit dhe planit të biznesit. Objektivat dhe synimet që janë paraparë për tu bërë implementimi i plotë i korporatizimit, rezultojnë me funksionimin e suksesshëm të kompanive në baza komerciale, përfshijnë si në vijim:

- ndërtimin dhe rritjen e kapaciteteve personale të stafit kyç menaxhues, dhe stafit tjetër përmes kurseve për trajnimin dhe trajnimin të vazhdueshëm në vend pune;
- implementimin e strukturës së re të miratuar organizative e cila do të reflektonte edhe shthurjen në aspektin kontabël dhe organizativ të aktiviteteve të biznesit në pajtim me ligjet dhe rregulloret e energjisë;
- përmirësimin e situatës financiare - shndërrimi në një biznes me vetëqëndrueshmëri financiare, që në mes tjerash përfshinë masat siç janë: i) mbledhja e borxheve të vjetra dhe rritja e shkallës së arkëtimit për 10%, përkatësisht 5%, me synim që niveli i përgjithshëm në vitin 2010 të arrijë 92%, përkatësisht 75% për NQ Termokos dhe NQ Gjakova; ii) krijimin dhe implementimin e strategjisë së tregut me synim të rritjes së pjesës së tregut përmes kyçjes dhe rikyçjes të ndërtesave ekzistuese ose zonës së afërt të shërbimit, dhe përmes zgjerimit të rrjetit të shpërndarjes përmes kyçjeve të reja të blloqeve të reja banesore; iii) përmirësimi i sistemit kontabël dhe raportues përmes zhvillimit të një sistemi kompjuterik të integruar për menaxhimin e informatave;
- përmirësimin e shërbimit të konsumatorëve dhe zhvillimi i standardeve të shërbimeve, përfshirë këtu furnizimin e qëndrueshëm dhe cilësor me ngrohje me anë të shërbimeve me kosto më të ulët për ngrohjen e hapësirave dhe me mundësi fillimit të furnizimit me ujë të ngrohtë, jo për qëllime ngrohjeje, azhurimin e bazës së të dhënave të konsumatorëve, krijimin e një baze të të dhënave në nivel të nënstacioneve e cila më së shumti implikon njehsimin e ngrohjes dhe kalimit nga tarifa "normative" për metër katror, në tarifë të bazuar në konsumin e energjisë, zhvillimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorëve, etj.;
- implementimin e investimeve të matura me qëllim të veçantë në uljen e shkallës së humbjeve të gjenerimit dhe shpërndarjes, në mënyrë që përmes ofrimit të ngrohjes së qëndrueshme, të mjaftueshme, konkurrenente dhe me kosto më të vogël të sigurohet që konsumatorët të janë të kënaqur. Një "bazë operative e të dhënave" të zhvillohet dhe të mirëmbahet rregullisht në lidhje me këtë, që do të përfshinte evidencat në lidhje me konsumin e njehsuar të derivateve (mazutit), nxehtësisë së gjeneruar, nxehtësisë së

furnizuar dhe humbjeve. Për tu siguruar burimi i lirë i ngrohjes, NQ Termokos në mënyrë serioze ka marrë parasysh investimet në bashkëgjenerim, të lidhjes me TC Kosva B për të cilin është përfunduar studimi i realizueshmërisë.

Për dallim nga Sh.A.-të siç janë Termokosi dhe Gjakova, njësitë e ngrohjes qendrore (NjNQ) Termomiti dhe Zveçani, ende janë pjesë e ndërmarrjeve të integruara komunale “Standard” në Mitrovicë, përkatësisht Zveçan.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në Sektorin e ngrohjes qendrore në Kosovë gjatë vitit 2006 ishte licencimi i kompanive të ngrohjes qendrore nga ZRRE-ja. Në të vërtetë, pas pranimit të kërkesave dhe vlerësimit të saktësisë dhe tërësisë së tyre, ZRRE-ja, më 4 tetor 2006 për secilin aktivitet të ngrohjes lëshoi këto licenca:

Licencë për gjenerimin e ngrohjes qendrore për ngrohjen qendrore “Termokos” Sh.A. – kohëzgjatja: 15 vite;
Licencë për shpërndarjen e ngrohjes qendrore për ngrohjen qendrore “Termokos” Sh.A. – kohëzgjatja: 15 vite;
Licencë për furnizim publik me ngrohje qendrore për ngrohjen qendrore “Termokos” Sh.A. – kohëzgjatja: 10 vite;
Licencë për gjenerimin e ngrohjes qendrore për ngrohjen qendrore “Gjakova” Sh.A. – kohëzgjatja: 15 vite;
Licencë për shpërndarjen e ngrohjes qendrore për ngrohjen qendrore “Gjakova” Sh.A. – kohëzgjatja: 15 vite;
Licencë për furnizim publik me ngrohje qendrore për ngrohjen qendrore “Gjakova” Sh.A. – kohëzgjatja: 10 vite.

Duhet theksuar se edhe pas disa kërkesave të ZRRE-së, ngrohjet qendrore “Termomiti” dhe “Zveçani” nuk kanë dorëzuar kërkesë për licencim dhe si pasojë këto dy kompani kanë mbetur të palicencuara.

Kriteret, kushtet dhe obligimet e dhëna në secilën licencë janë si vegël për monitorim të rregullt dhe të duhur të kompanive për ngrohje qendrore në kryerjen e aktiviteteve të tyre të lidhura me ngrohjen qendrore, ashtu siç parashihet në licenca.

6.2 Performansa e kompanive të ngrohjes qendrore

Ngrohja qendrore në Kosovë përbëhet nga katër sisteme: në Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan, të cilat kryesisht furnizojnë me ngrohje qendrore zonat urbane me popullsi të dendur të komunave në fjalë.

6.2.1 Konsumi i derivateve dhe gjenerimi i ngrohjes

Gjenerimi i ngrohjes bëhet në ngrohtoret qendrore të pajisura me kaldaja të cilat kryesisht përdorin mazut dhe në masë të vogël përdorin naftë, të cilat importohen me çmime të bursës së mallrave plus një premium për mbulimin e shpenzimeve të furnizuesit. Më poshtë është paraqitur shkalla e konsumit të derivateve dhe çmimet e blerjes gjatë periudhës së ngrohjes 2005/2006, sipas të dhënave të raportuara nga KNQ-të.

Tabela 6.1: Konsumi i derivateve dhe çmimi mesatar blerës për sezonin 2005/2006

Kompania – Sistemi i NQ-së	Mazuti		Nafta	
	Kons. të ton	Çmimi mesatar blerës (euro/ton)	Kons. (litër)	Çmimi mesatar blerës (euro/litër)
TERMOKOS - Prishtina	13,546.00	292.00	21,000	0.95
NQ GJAKOVA	1,719.93	279.61	NA	NA
TERMOMIT - Mitrovica	NA	NA	NA	NA
NQ ZVEÇAN	NA	NA	60,000	1.00
Totali i Sektorit të NQ-ve	15,256.93		81,000	

NA – Nuk është në dispozicion (ose nuk aplikohet)

Objektet e “Termokosit” për gjenerimin e ngrohjes përbëhen nga kaldaja kryesore me një kapacitet 116 MW – dy kaldaja me mazut me kapacitet 58 MW për secilën dhe një kapacitet rezervë – një kaldajë me mazut me kapacitet 29 MW (nuk është në funksion) dhe dy kaldaja me naftë në qendrën spitalore me një kapacitet të tërësishëm prej 14 MW (secila kaldajë ka kapacitetin 7 MW).

Ngrohtorja e NQ “Gjakova” ka dy kaldaja me mazut. Njëra ka kapacitet 20 MW, ndërsa tjetra 18.6 MW, e që gjithsej bëjnë 38.6 MW. Kaldaja e vogël (18.6) MW është jashtë funksionit.

Objektet gjeneruese të “Termomit-it” përbëhen nga ngrohtorja “Lisic Polje” e pajisur me një kaldajë me mazut e cila ka kapacitet nominal prej 9.3 MW dhe një ngrohtoreje e cila gjendet në qendrën spitalore dhe ka tri kaldaja shumë të vogla me mazut, me kapacitet të përgjithshëm prej 7.6 MW. Gjenerimi i ngrohjes në Zveçan bëhet në një ngrohtore e cila është e pajisur me dy kaldaja me naftë, ku kapaciteti i secilës është 800 kW.

6.2.2 Shpërndarja e ngrohjes

Të gjitha sistemet e ngrohjes qendrore kanë një karakteristikë të përbashkët, e ajo është se rrjeti i tyre shpërndarës përfshinë vetëm ato pjesë të qytetit që kanë popullatë të dendur, apo pjesët me ndërtesa banesore. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga rrjeti primar që shtrihet deri në pikën e furnizimit që gjendet në nënstacion dhe rrjeti sekondar i cili shtrihet nga pika e furnizimit në nënstacion.

Gypat e rrjetit të shpërndarjes së ngrohjes të “Termokosit” shtrihen në gjatësi prej 28 km. Kapaciteti i rrjetit të shpërndarjes është tejdzajnuar, gjë që kupton se kapaciteti i shpërndarjes është rreth 300 MW. Një pjesë përbërëse e rrjetit të shpërndarjes është stacioni i pompës dhe shkëmbyesit e nxehtësisë që gjendet në Bregun e Diellit dhe 245 nënstacione të cilat janë pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar.

Gypat e rrjetit të shpërndarjes së NQ Gjakova shtrihen në gjatësi prej 13 km, 4 nga të cilat janë gypa të ndërtuar rishtazi në vitin 2001 dhe rreth 1 km në vitin 2006, si dhe rreth 101 nënstacione të cilat janë pjesë e rrjetit dhe pika ndarëse ndërmjet rrjetit primar dhe sekondar. Njehsorët e nxehtësisë janë instaluar në 42 nënstacione.

Rrjeti i shpërndarjes së “Termomitit” përbëhet nga dy pjesë të veçanta. Pjesa kryesore e rrjetit është e lidhur në ngrohtoren “Lisic Polje”, ndërsa tjetra me ngrohtoren e cila gjendet në hapësirat e spitalit. Gjatësia totale e gypave është rreth 4.5 km.

Rrjeti shpërndarës i Zveçanit është shumë i vogël dhe ka një gjatësi prej 0.8 km.

Një përmbledhje e karakteristikave teknike të sistemeve të NQ-ve: të dhënat e gjenerimit dhe furnizimit me ngrohje.

Tabela 6.2: Karakteristikat teknike të sistemeve të ngrohjes qendrore

Kompania (Vendi)	Kapaciteti i instaluar	Kapaciteti Operacional	Rrjeti Shpërndarjes		Gjenerimi i ngrohjes. [MWh / vitr]	Furnizimi me ngrohje në nënstacione të konsumatorëve. [MWh/vit]
	[MW]	[MW]	Gjatësia rrjetit [km]	Nr. nëntat	Sezoni 2005/06	Sezoni 2005/06
TERMOKOS (Prishtinë)	2 x 58 = 116 1 x 29 = 29 2 x 7 = 14	2 x 58 = 116 2 x 7 = 14	28	245	136,348	108,580
Nëntotal	159	130	28	245	136,348	108,580
KNQ Gjakova	1 x 20.0 = 20.0 1 x 18.6 = 18.6	1 x 20 = 20	13	101	13,071	9,816
Nëntotal	38.6	20	13	101	13,071	9,816
TERMOMIT (Mitrovicë)	1 x 9.3 = 9.3 2 x 3.3 = 6.6 1 x 1.0 = 1.0	1 x 9.3 = 9.3 2 x 3.3 = 6.6 1 x 1.0 = 1.0	4.5	20	NA	NA
Nëntotal	16.9	16.9	4.5	20	NA	NA
NQ Zveçan	2 x 0.8 = 1.6	2 x 0.8 = 1.6	0.8	NA	NA	NA
Nëntotal	1.6	1.6	0.8	NA	NA	NA
Totali	216.1	168.5	46.3	366	149,419	118,396

6.2.3 Çështje lidhur me konsumatorët

Shërbimi i furnizimit

Hapësira aktuale e shërbimit të furnizimit të mbuluar nga “Termokos-i”, për të dy grupet e konsumatorëve – grupi i konsumatorëve shtëpiak, konsumatorëve komercial dhe institucional – është rreth 1.046.800 m², përkatësisht 611.700 m² dhe 418.000 m². “Termokosi” gjithsej i furnizon rreth 12.100 konsumatorë, prej tyre 11.450 amvisëri dhe 560 konsumatorë komercial dhe publik.

Hapësira totale e vlerësuar e shërbimit të furnizimit të NQ “Gjakova” është 134.000 m². Proporcioni ndërmjet grupit të amvisërive dhe grupit të konsumatorëve komercial dhe institucional është përafërsisht 45 -55 % (ose 61.000 m² dhe 73.000 m²). Duhet theksuar se në realitet hapësira e shërbimit të furnizimit gjatë sezonit 2005/2006 ishte 57700 m², për amvisëri dhe 54.000 m², për konsumatorë komercial dhe institucional për shkak të kyçjeve që janë bërë.

Hapësira e shërbimit të furnizimit të “Termomit-it” mbulon edhe grupin e amvisërive, por edhe grupin konsumatorëve komercial dhe publik. Grupi i amvisërive nuk është furnizuar gjatë sezonit të kaluar për shkak të gjendjes së keqe të rrjetit dhe sistemit sekondar. Hapësira e shërbimit të

furnizimit për grupin e konsumatorëve komercial dhe institucional është vlerësuar të jetë rreth 27.100 m².

Hapësira e shërbimit të furnizimit Zveçan përfshinë vetëm grupin e konsumatorëve komercial dhe institucional dhe është vlerësuar të jetë 8.900 m².

Faturimi dhe arkëtimi

Për shkak të mungesës së implementimit të njehsorëve të ngrohjes, faturimi për secilin konsumator bëhet në bazë të sipërfaqes (metër katror). Janë vërejtur vështirësi sa i përket faturimit në kuptim të mos arritjes së nivelit të planifikuar të faturimit për shkak të zbritjes së ditëve pa ngrohje të shkaktuara nga prishjet e sistemit (ngrohtorja, rrjeti), shkalla akoma e lartë e rrjedhjes së ujit (në sezonin e ngrohjes 2005/2006 vlerësohet rreth 200 m³ në ditë) dhe një bazë jo e sigurt e të dhënave të konsumatorëve.

Niveli mesatar i arkëtimit për sezonin 2006/2007 vlerësohet të jetë rreth 35% për shkak të një varg faktorësh të ndryshëm. Disa janë drejtpërdrejtë të lidhur me ndërmarrjet e NQ-së siç janë: gjenerimi dhe realizimi i furnizimit, shërbimi për konsumatorë dhe joefikasiteti në faturim dhe arkëtim. Faktorët tjerë të lidhur me situatën e përgjithshme ekonomike dhe të ardhurave të popullsisë janë mundësia dhe vullneti për të paguar, mungesa e administratës banesore dhe masa të pasigurta ligjore në marrjen me çështje të mospagesës nga konsumatorët.

Tabela 6.3 Shkalla e arkëtimit në kompanitë e NQ-ve në Kosovë për sezonin 2005/2006

Sezona e ngrohjes 2005/2006	Hapësira ngrohëse [m ²]	Tarifa	Faturimi (përfshirë TVSH-në) [€]	Arkëtimi [€]	Shkalla e arkëtimit %
Termokos - Prishtina					
Amvisëritë	611,724	0.80	2,580,910	489,688	18.97
Komercial dhe institut.	435,124	0.96	2,241,802	974,283	43.46
Totali	1,046,848		4,822,712	1,463,971	30.36
KNQ - Gjakova					
Amvisëritë	57,739	0.85	286,385	66,287	23.15
Komercial dhe publik	57,000	1.26	448,810	201,119	44.81
Totali	111,739	-	735,195	267,406	36.37
Termomit - Mitrovica					
Amvisëritë	0	NA	NA	NA	NA
Komercial dhe publik	27,100	1.30	NA	NA	NA
Totali	27,100		NA	NA	NA
NQ ZVEÇAN					
Amvisëritë	0	NA	NA	NA	
Komercial dhe institut.	8,889	1.23	60,319	51,000	84.55
Totali	8,889		60,319	51,000	84.55

NA – Nuk është në dispozicion (ose nuk aplikohet)

6.3 Shqyrtimi i çmimeve për ngrohje qendrore – sezoni 2006/2007

6.3.1 Korniza ligjore dhe rregullative për shqyrtimin e çmimit për ngrohje qendrore

Në pajtim me legjislacionin primar – nenet 46, 47, 48 të Ligjit për rregullatorin e energjisë, ZRRE-ja ka autoritet për krijimin e metodologjisë së tarifave dhe ka miruar tarifat në Sektorin e rregulluar të energjisë. Janë një sërë parimesh të gjëra të cilat thërrasin për parime të arsyeshme,

të justifikueshme dhe jodiskriminuese sipas të cilave ndërmarrjet energjetike duhet t'i rikthejnë të gjitha kostot e arsyetuara, përfshirë këtu edhe kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre.

Sektori i ngrohjes qendrore në Kosovë në transmision dhe në shpërndarje të ngrohjes klasifikohet si monopol natyror, pasi që tani për tani nuk ekziston ndonjë konkurrencë në prodhimin dhe furnizim me ngrohje. Prandaj, tarifat e ngrohjes qendrore i nënshtrohen miratimit nga ZRRE-ja.

ZRRE-ja sipas obligimeve ligjore dhe kompetencave të saja, më 2 maj 2006 ka shpallur fillimin e shqyrtimit të çmimeve për ngrohje qendrore për sezonin 2006/2007, me objektiv kryesor: vlerësimin real të informatave financiare dhe teknike të ofruara nga KNQ-të në mënyrë që tarifat e ngrohjes qendrore të jenë me kosto refleksive.

ZRRE-ja në lidhje me këtë lëshoj dy udhëzime:

- Udhëzimin e përkohshëm I_02_2006 e Raportimit rregullativ të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore, nxjerrë më 30 qershor 2005, në të cilin janë përcaktuar procedurat për dorëzimin e raporteve rregullative dhe përmbajtjen e raportimit rregullativ për sezonin 2005-2006;
- Udhëzimin e përkohshëm I_02_2005 e Parimit dhe llogaritjes së tarifave dhe çmimeve në Sektorin e ngrohjes qendrore në Kosovë për sezonin 2006/2007, nxjerrë më 12 qershor 2006, ku janë përcaktuar procedurat për dorëzimin dhe miratimin e tarifave dhe caktimin e metodologjisë për llogaritjen e tyre.

Përmbajtja e udhëzimeve

- Udhëzimi I_01_2005 e Raportimit rregullativ përmban përshkrim të hollësishëm të përmbajtjes së informatave që duhet dorëzuar gjatë raportimit rregullativ në sezonin 2005-2006, dhe afatet për dorëzimin e tyre. Ky udhëzim gjithashtu përmban udhëzime të hollësishme për plotësimin e pasqyrave rregullative. Shtojcat e udhëzimit – Shtojca 1: pasqyrat rregullative; dhe shtojca 2: mostra e raportit rregullativ të auditorit;
- në Udhëzimin I_03_2006 janë dhënë në hollësi procedurat për dorëzimin dhe miratimin e tarifave për sezonin 2006/2007, dhe metodologjia e tarifave që zbatohen. Udhëzimi I_03_2006 si shtesë përmban: shtojcën 1 – llogaritja e normës së kthimit (NeK) në RAB dhe shtojca 2 – detajet për llogaritjen e tarifës.

Metodologjia e tarifave

Për formulimin/llogaritjen e tarifave dhe çmimeve është zbatuar metodologjia e normës së kthimit (NeK) (ose e ashtuquajtura kosto plus), është zbatuar për formulimin/kalkulimin e tarifave dhe çmimeve. Metodologjia NeK definon koston e lejuar e cila duhet të rikthehet dhe profitin e arsyeshëm i cili duhet të nxirret nga KNQ-ja, e cila është llogaritur sipas normës së lejuar të kthimit (Nek) mbi bazën e rregulluar të aseteve.

6.3.2 Procesi i shqyrtimit të çmimeve

Në mënyrë që të arrihet një progres dhe përfundim i suksesshëm i procesit të shqyrtimit të çmimeve, ZRRE-ja, me kohë ka filluar përgatitjet e saj përmes lëshimit të udhëzimeve dhe publikimit të tyre në uebfaqen zyrtare dhe dokumenteve tjera siç janë: shpallja, plani i implementimit dhe orari, etj. Si shtesë është mbajtur mbledhje informative dhe janë bërë

ndërveprime tjera me KNQ-të dhe hisedarët tjerë relevant të sektorit me qëllim që të shpjegohen dhe sqarohen udhëzimet dhe aspektet kryesore të procesit të shqyrtimit të çmimeve.

Sipas procedurave të parapara në udhëzimet e lartpërmendura, procesi i shqyrtimit të çmimeve ka filluar me dorëzimin e raporteve rregullative dhe pakos së aplikacionit për tarifa nga ndërmarrjet e NQ-së në ZRRE. Duhet theksuar se edhe përkundër faktit që raportimi rregullativ dhe aplikacionet ishin më komplete se në vitet paraprake, ZRRE-ja edhe këtu është përballur me vështirësi siç janë: vonesat në dorëzimin, por edhe mosdorëzimi (siç është rasti i “Termomit” – Mitrovicë, e cili nuk ka dorëzuar raportin rregullativ, as aplikacionin për tarifa, si dhe NQ Zveçan e cila nuk ka dorëzuar aplikacionin për tarifa), mosbesueshmëria dhe moskompletimi i informatave, të dhënave dhe dokumenteve të kërkuara përkatëse.

Në procesin e shqyrtimit të çmimeve janë përfshirë këto faza kryesore:

- barazimi i të hyrave ndërmjet të hyrave të projektuara dhe të realizuara për sezonin paraprak të ngrohjes (2005/2006), gjë që ka pasur si rezultat krahasimin e të dhënave aktuale të dhëna në raportet rregullative, me të dhënat e parashikuara në caktimin e tarifave për periudhën paraprake të cilat do të përfshihen në të hyrat e lejuara për sezonin pasues 2006/2007;
- përcaktimi i të hyrave të lejuara në bazë të: informatave dhe të dhënave të parashikuara të dorëzuara me aplikacionin për tarifa: ii) informatat e paraqitura në raportin financiar, p.sh. të dhënat financiare, teknike dhe të konsumatorëve të cilat janë realizuar në sezonin e ngrohjes 2005/2006; iii) barazimin e tarifës aktuale me tarifën e projektuar;
- llogaritja e tarifave bazuar në të hyrat e lejuara dhe propozimin për tarifa të cilat i janë nënshtruan miratimit përfundimtar nga ZRRE-ja.

Si rrjedhojë e fazave të lartpërmendura, ZRRE-ja nxori këto dokumente:

- barazimin për KNQ “Termokos”, “Gjakova” dhe Zveçani, të shoqëruara me raporte gjithëpërfshirëse rregullative për secilën KNQ të cilat janë dhënë si shtojca të barazimit. Në këto raporte është paraqitur vlerësimi i raportit rregullativ dhe krahasimi i të hyrave (reale) të realizuara, kostove, prodhimit, furnizimit dhe të dhënave tjera teknike dhe të konsumatorëve për sezonin 2005/2006 me të dhënat të cilat i janë paraqitur ZRRE-së, si parashikime për caktimin e tarifave për sezonin 2005/2006;
- vendimet për miratimin e të hyrave të lejuara për KNQ “Termokos” (D_17_2006) dhe për KNQ “Gjakova”, e të cilat janë përcjellë me një raport gjithëpërfshirës të hollësishëm rregullativ në formë të shtojcës së vendimit për të hyrat e lejuara. Raporti rregullativ përbëhet nga këto pjesë kryesore:
 - parimet dhe formulimi i metodologjisë së tarifave bazuar në NeK, ku në mënyrë të veçantë janë paraqitur parimet themelore të metodologjisë, formulimi i cili përbëhet nga llogaritja skematike e të hyrave të lejuara, dhe formulat themelore të rregullimit.
 - Në vendimin për të hyrat e lejuara kryesisht janë përfshirë si më poshtë:
 - vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara të cilat kanë në vete shpjegimin dhe arsyetimin analitik për përcaktimin e vlerës së lejuar për secilin grup të kostove dhe për gati të gjitha pozicionet kryesore që përbëjnë grupet e caktuara të kostove;
 - vlerësimi dhe përcaktimi i shkallës së zhvlerësimit;

- përcaktimi i kthimit të lejuar mbi bazën e BRRrA-së, ku përfshihen: i) vendosja e BRRrA-së; dhe ii) llogaritja e MPKK-së dhe profitit të lejuar;
- barazimi i tarifave aktuale bazuar në diferencën ndërmjet të hyrave të projektuara dhe aktuale të sezoneve paraprahe.

Duhet theksuar se përcaktimi i të hyrave të lejuara ka qenë bazë e llogaritjes së tarifave përfundimtare dhe dorëzimit të propozimit për tarifa nga ndërmarrjet e NQ-së në ZRRrE për miratim.

Vendimet për miratimin e normave të tarifave dhe shtojcave përkatëse për secilën kompani të NQ me të cilat është përfunduar shqyrtimi i çmimeve për sezonin 2006/2007 janë si vijon:

- vendimi D_22_2006 i lëshuar më 9 nëntor 2006 mbi miratimin e tarifave për KNQ Gjakova;
- vendimi D_23_2006 i lëshuar më 15 nëntor 2006 mbi miratimin e tarifave për KNQ “Termokos”;
- vendimi D_24_2006 i lëshuar më 22 nëntor 2006 mbi miratimin e tarifave për NjNQ “Termomit”, Mitrovica; dhe
- vendimi D_25_2006 i lëshuar më 5 dhjetor 2006 mbi miratimin e tarifave për NjNQ e PMU Zveçan;

Më poshtë janë dhënë tarifat përfundimtare të miratuara për 4 KNQ:

Tabela 6.4: Tarifat për kompanitë e ngrohjes qendrore në Kosovë – sezoni 2006/2007

A. TARIFAT E NGROHJES PËR KONSUMATORËT JO TË NJEHSUAR			
KOMPANITË NQ	Komponentët e tarifave	Amvisëri m ² në muaj	Komerc. dhe Instit për m ² në muaj
NQ TERMOKOS Sh.A.	Kapaciteti për ngrohje i kontraktuar (komp. fikse)	€ 0.09	€ 0.11
	Ngrohja e liferuar (komp. variabl)	€ 0.70	€ 0.84
NQ GJAKOVA Sh.A.	Kapaciteti për ngrohje i kontraktuar (komp. fikse)	€ 0.18	€ 0.23
	Ngrohja e liferuar (komp. variabl)	€ 0.69	€ 1.03
NPK Standard / NjNQ Temomit	Kapaciteti për ngrohje i kontraktuar (komp. fikse)	NA	€ 0.25
	Ngrohja e liferuar (komp. variabl)	NA	€ 1.05
NPK ZVEÇAN	Kapaciteti për ngrohje i kontraktuar (komp. fikse)	NA	€ 0.10
	Ngrohja e liferuar (komp. variabl)	NA	€ 1.13

B. TARIFAT E NGROHJES PËR KONSUMATORËT E NJEHSUAR		
KOMPANITË NQ	Komponentët e tarifave	për njësi matëse
NQ TERMOKOS Sh.A.	Kapaciteti për ngrohje i kontraktuar (komp. fikse)	€ 0.86 / kW në muaj
	Ngrohja e liferuar (komp. variabl)	€ 44.70 / MWh
NQ GJAKOVA Sh.A.	Kapaciteti për ngrohje i kontraktuar (komp. fikse)	€ 1,86 / kW në muaj
	Ngrohja e liferuar (komp. variabl)	€ 50,10 / MWh
NPK Standard / NjNQ Temomit	Kapaciteti për ngrohje i kontraktuar (komp. fikse)	NA
	Ngrohja e liferuar (komp. variabl)	NA
NPK ZVEÇAN	Kapaciteti për ngrohje i kontraktuar (komp. fikse)	NA
	Ngrohja e liferuar (komp. variabl)	NA

NA – nuk aplikohet

6.3.3. Përcjellja e implementimit të tarifave për sezonin 2006/2007

ZRRE-ja gjatë aktiviteteve të përcjelljes nga afër bën monitorimin e implementimit të tarifave përmes kontakteve dhe mbledhjeve të rregullta me KNQ-të. Ndërveprimet me KNQ-të përfshijnë kërkesat për reagimet në lidhje me realizimin e faturimit, arkëtimin e pagesave të konsumatorëve, ndikimin e tarifave në shkallën e arkëtimit dhe numrin e konsumatorëve të faturuar me “tarifa normative” dhe “tarifa për konsumin e energjisë”.

ZRRE-ja vazhdimisht inkurajon KNQ-të të kalojnë nga “tarifa normative” në “tarifën e konsumit të energjisë”, sa më shumë që është e mundur duke theksuar disa fakte: “tarifa e konsumit të energjisë” e bazuar në konsumin real të matur është në favor të nxitjes së konsumatorëve për ruajtjen e energjisë sipas nevojave të tyre; faturimi i drejtë – p.sh. konsumatorit i faturohet vetëm energjia e cila është konsumuar – e cila mund të ngritë shkallën e arkëtimit dhe përfundimisht implementimi i “tarifës së konsumit të energjisë” e cila do të jetë një kërkesë ligjore që del nga Ligji për ngrohje qendrore, i cili është në proces të shpalljes.

KAPITULLI 7

ZHVILLIMET RAJONALE DHE MARRËDHËNIET INSTITUCIONALE

7.1 Komuniteti energjetik i EJJ - ECRB

Komuniteti energjetik i EJJ-së është një proces i cili ka për synim zgjerimin e tregut të brendshëm të energjisë në BE në rajonin e Evropës Juglindore. Për këtë qëllim, më 25 tetor të vitit 2005 në Athinë u nënshkru TRAKTATI PËR KRIJIMIN E KOMUNITETIT ENERGJETIK (KEEJJ). Kosova ka qenë njëra ndër palët e para nënshkruese e cila ka ratifikuar traktatin, i cili zyrtarisht ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2006. Institucionet kryesore të themeluara për mbikëqyrjen e procesit janë: Këshilli i Ministror, Grupi i përhershëm i nivelit të lartë, Bordi rregullativ (ECRB), Fora dhe Sekretariati.

ZRRE-ja është si kujdestare e kërkesave të Traktatit për Kosovë (implementimi i “acquis communautaire” (legjislacioni i komunitetit evropian) në lidhje me energjinë, konkurrencën, mjedisin dhe ripërtëritjen). ZRRE-ja gjatë vizitës së parë Sekretariatit të KE-së u përgjigj për monitorimin e harmonisë së legjislacionit kombëtar me kërkesat e Traktatit dhe së bashku me MEM-in përgatitën draftin e një rruge të propozuar për implementimin e tij.

Gjatë vitit 2006, stafi i ZRRE-së ka marrë pjesë dhe rregullisht ka kontribuar në mbledhjet dhe forumet e procesit, që kryesisht ishin:

më 22-23 mars	Grupi i përbashkët punues për gaz;
më 27-28 mars	Miniforumi për energji elektrike;
më 22-23 qershor	Forumi i 8-të i Athinës
më 12-13 tetor	Forumi për gaz dhe Grupi punues i përbashkët për investime dhe rregullim të infrastrukturës së gazit.
më 23 tetor	ECRB;
më 24-25 tetor	Forumi i 9-të i Athinës;
më 11 dhjetor	Mbledhja inaugurale e ECRB-së.

Sa i përket kompetencave të ECRB-së, ato janë të përshkruara në Titullin V të Traktatit të KEEJJ-it ku në Kapitullin III definohen autorizimet, detyrat dhe përgjegjësitë, formësia dhe procedurat e Bordit rregullativ. Bordi rregullativ këshillon Këshilli i Ministror ose Grupin e përhershëm të nivelit të lartë në lidhje me hollësitë e rregullave statutores, teknike dhe rregullative; nxjerrjë rekomandime për kontestet ndërkufitare në të cilat përfshihen dy apo më shumë rregullatorë, me kërkesën e tyre; ndërmarr masa, nëse për një gjë të tillë autorizohet nga Këshilli i ministrave; miraton aktet procedurale.

Bordi rregullativ përbëhet nga një përfaqësues i secilit rregullator për energji në secilën palë kontraktuese, sipas pjesëve relevante të legjislacionit të komunitetit për energji. Komuniteti evropian do të përfaqësohet nga Komisioni evropian, i ndihmuar nga një rregullator nga secili pjesëmarrës dhe nga përfaqësuesi i Grupit të rregullatorëve evropian për energji elektrike dhe gaz (GRrEEEG). Nëse pala kontraktuese ose pjesëmarrësi ka një rregullator për gaz dhe një për energji elektrike, atëherë pala kontraktuese ose pjesëmarrësi në bazë të agjendës do të vendosin se cili prej tyre do të merr pjesë në mbledhjen e Bordit rregullativ.

Bordi rregullativ përmes një akti procedural miraton rregullat e brendshme procedurale (e arritur në muajin shkurt 2007).

Bordi rregullativ nga radhët e veta do të zgjedh presidentin për një afat të përcaktuar. Komisioni evropian do të ketë kapacitetin e nënkryetarit. Kryetari dhe nënkryetari përgatisin draftin e rendit të ditës.

7.2 ShRRrE/FRrB/ShKKRrK

ZRRE-ja është anëtare e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve për Energji (ShRRrE) dhe në mënyrë aktive merr pjesë në grupet punuese dhe komisionet e kësaj shoqate.

Përfaqësuesi i ZRRE-së gjatë vitit 2006 në mënyrë aktive ka ndjekur dhe ka marrë pjesë në:

- mbledhjet e Komisionit të ShRRrE-së për licencim në: Riga (më 7 e 8 shtator), Budapest (18 maj) dhe Shkup (23 e 24 shkurt 2006);
- mbledhjet e Komisionit të ShRRrE-së për çmimvënie/tarifa në: Varshavë (më 6 e 7 shkurt), Budapest (18 maj) dhe Shisinau, Moldavi (14 e 15 shtator, 2006);
- grupin punues të ShRRrE-së për çështje ligjore të mbajtur më 27 dhe 28 mars 2006 në Budapest.

Si shtesë e kësaj, anëtarët e Bordit të ZRRE-së në maj të vitit 2006 kanë ndjekur mbledhjen vjetore të ShRRrE-së dhe Konferencën për investime.

Anëtarët e stafit të ZRRE-së që kanë marrë pjesë në ShRRrE kanë prodhuar disa studime krahasimtare dhe dokumente diskutimi dhe kanë bërë disa prezantime në lidhje me rolin dhe funksionet e rregullatorit dhe për procedurën e ndërtimit të kapaciteteve të reja. Prezantimet dhe studimet janë publikuar në uebfaqen e ShRRrE-së dhe janë trajtuar si kontribut në Sektorin e energjisë të vendeve të EJJ-së.

Gjatë vitit 2006, anëtarët e stafit që kanë ndjekur mbledhjet e grupeve punuese dhe komisioneve të ShRRrE-së kryesisht kanë qenë të sponzuara nga Shoqata Kombëtare e SHBA-ve e komisionarëve rregullativ për komunalitet (ShKKRrK).

Në periudhën 9-11 tetor 2006, një anëtar i Bordit të ZRRE-së është dërguar për përfaqësimin e kësaj zyre në Forumin Botëror për Rregullimin e Energjisë III.

7.3 Konferencat dhe trajnimet e ZRRE-së

Përfaqësuesit e ZRRE-së gjatë vitit 2006 kanë marrë pjesë në disa mbledhje pune (workshope), trajnime dhe udhëtime studimore. Qëllimi i këtyre vizitave ka qenë ofrimi i mundësive për anëtarët e stafit të ZRRE-së që të përfitojnë nga përvoja dhe problemet e ngjashme të rregullatorëve të tjerë.

Është me rëndësi të theksohet se shumica e aktiviteteve dhe konferencave të përmendura më poshtë janë organizuar nën patronatin e Traktatit të KEEJL-it dhe Shoqatës rajonale të rregullatorëve për energji (ShRRrE-ja):

- **Vizitë pune në Shqipëri për mekanizmin TNK, 17-19 janar 2006, Tiranë, Shqipëri.** Kryesuesi i Departamentit për strukturën e furnizimit dhe tregut të energjisë (SFTE) në ZRRE ka marrë pjesë në takim pune me KESH-OST Shqipëri, ku temë diskutimi ka qenë mekanizmi i quajtur TNK;
- **mbledhja e TF të OSTEJL-it në Zagreb, Kroaci, 20 janar 2006.** Në këtë mbledhje ka marrë pjesë Kryesuesi i ZRRE-së;
- **trajnimi për informata rregullative dhe pjesëmarrje publike (Budapest, Hungari) 22-25 janar 2006;** Në trajnimin e organizuar nga ShRRrE-ja dhe ShKKRrK-ja ka marrë pjesë Kryesuesi i DMK-së në cilësinë e përfaqësuesit të ZRrE-së;
- **mbledhje pune për monitorimin rregullativ të Sektorit të energjisë elektrike (Kazakistan).** Mbledhje pune për monitorim rregullativ të Sektorit të energjisë elektrike, organizuar nga ShKKRrK-ja, ShRRrE-ja dhe Agjencia e Republikës së Kazakistanit për rregullimin e monopoleve natyrore, sponsoruar nga USAID-i;
- **mbledhja e grupit punues KRRrEE dhe rregullatorët për energji në Evropën Juglindore (RrEEJL) dhe mbledhja e grupit rregullativ për gaz, mbajtuar në hapësirat e Autoritetit Rregullativ të Italisë (AEEG) në Milano (Itali).** Në mbledhjet e lartpërmendura kanë marrë pjesë Shefi i ZRRE-së dhe eksperti për ngrohje qendrore;
- **mbledhja e Komisionit të ShRRrE-së për licencin/konkurrencë;** Në mbledhjen e këtij komisioni ka marrë pjesë Kryesuesi i DÇLL-së (Anëtar i Bordit) në cilësinë e anëtarit të ZRRE-së;
- **mbledhja e 2-të e TF-së së Konsumatori i Evropës Juglindore (KEJL) (Vjenë, Austri, 9 mars);** Kryesuesi i DMK të ZRRE-së në cilësinë e anëtarit të TF-së së KEJL-it ka marrë pjesë në mbledhjen e dytë të kësaj TF;
- **grupi punues i përbashkët për industrinë dhe infrastrukturën e gazit, financimin dhe rregullimi (Beograd, 22-23 mars 2006);** Në mbledhjen e këtij grupi punues që kryesohet nga Komisioni Evropian kanë marrë pjesë eksperti për ngrohje qendrore dhe eksperti për gaz nga ZRrE-ja;
- **Miniforumi i Athinës dhe mbledhja e 15-të e GP të EJL-së (Dubrovnik, Kroaci, 27-28 mars 2006);** në këtë ngjarje morën pjesë Kryesuesi i ZRRE-së, eksperti për sistemin e energjisë elektrike dhe analisti për monitorim tregu;
- **mbledhje pune “Adresimi i sfidave kyçe të reformimit dhe rregullimit të ndërmarrjeve të rrjetit” (Londër, MB, 27-31 mars 2006);** Në këtë mbledhje pune mori pjesë këshilltari i lartë për tarifa dhe ekonominë rregullative në cilësinë e përfaqësuesit të ZRRE-së;
- **vizitë studimore në Romani, 10-15 mars 2006;** Kjo vizitë studimore në Romani u organizua nga projekti i AT-së në ZRRE (projekti i AER-it) ku nëntë anëtarë të stafit të ZRRE-së vizituan. ANRE, OPCOM, TRANSELECTRIKA dhe ELEKTRIKA. Kjo vizitë ka qenë mundësi e mirë për shkëmbim të përvojave me kolegët që kanë përvoja dhe praktika të ngjashme rregullative dhe për kuptim më të mirë të funksioneve të rregullatorit.
- **Mbledhja e OSTEJL (Budapest, Hungari, 12 maj 2006);** Në këtë mbledhje ka marrë pjesë Kryesuesi i ZRrE-së;
- **konferenca vjetore e ShRRrE-së për investime (Budapest, Hungari, 14-19 maj 2006);** Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë anëtarët e bordit të ZRRE-së;
- **vizitë studimore nga SEETEC (Paris, Stokholm, 17-19 maj 2006);** Në këtë vizitë studimore ka marrë pjesë analisti për monitorim të tregut në cilësinë e përfaqësuesit të ZRRE-së;
- **pjesëmarrja në SG të OSTEJL (Zagreb, Kroaci, 8 qershor 2006);** Mbledhje pune me temë “menaxhimi i balancimit”;

- **nënraioni i madh i Mekongut, mbledhje e Sektorit të energjisë organizuar nga BB. Siem Reap, Kamboxhi, 13-16 qershor 2006, Pjesëmarrje dhe Prezantim nga ana e Kryesuesit të ZRrE-së;**
- **përcjellja e Forumit të Athinës, të mbajtur në periudhën 19-24 qershor 2006, në Athinë, Greqi, nga Anëtarët e Bordit të ZRrE-së;**
- **mbledhja e Komisionit për tarifa/çmimvënie, mbajtur më 14-15 shtator 2006, në Shisinau, Moldavi;**
- **vizitë punuese në ERE, më 21-22 shtator 2006, Tiranë, Shqipëri**
- **Forumi Botëror për Rregullimin e Energjisë, Uashington DC, 9 -11 tetor 2006;**
- **miniforumi për Gaz, 12-13 tetor, Vjenë, Austri;**
- **mbledhje pune për tregjet ndërkombëtare të energjisë pas dy vite të Rilidhjes të UCTE-së, 17 tetor, Zagreb, Kroaci;**
- **mbledhje pune për dizajnimin e monitorimit të tregut të EJM-së, Bruksel, 16 nëntor 2006; Bruksel, 16 nëntor 2006;**
- **“Power-Gen International 2006 US”, Orlando, Florida, 24 nëntor 2006 deri 1 dhjetor 2006;**
- **mbledhje tripalëshe ndërmjet tre rregullatorëve: ERE-KRrERM-ZRrE, Tiranë, 1 dhjetor 2006;**
- **mbledhje Inauguruese e ECRB-së në Athinë, Greqi, 11 dhjetor 2006;**
- **strukturimi i kornizës rregullative për tregjet dinamike dhe konkurruese të Evropës Juglindore, Konferenca e Organizuar nga BB-Athinë më 18-19 dhjetor 2006.**

KAPITULLI 8

PASQYRA FINANCIARE 2006 - PLANI I BIZNESIT – PROJEKT DOKUMENTI

8.1 Raporti vjetor financiar i ZRrE-së për vitin 2006

Zyra e Rregullatorit për Energji në vitin 2006 është financuar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, Shtylla e IV-të e UNMIK-ut dhe organizatat e donatorëve. Që nga 1 gushti 2006 dhe sipas mandatit ligjor të dhënë me nenet 19 deri 24 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (2004/09) dhe në pajtim me dispozitat e legjislacionit sekondar "Pasqyra e taksave" të miratuar, ZRRE-ja filloj me mbledhjen e taksave nga të licencuarit, e në këtë mënyrë u bë institucion i pavarur vetëfinancues.

Shënimet shpjeguese:

Për aktivitetet e ZRRE-së nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për vitin 2006 janë alokuar 247.446,00 euro.

Buxheti i miratuar është alokuar në tri kategori kryesore:

1. paga dhe mëditje,
2. mallra dhe shërbime,
3. shpenzime komunale.

Shtylla e BE-së ka ndihmuar ZRRE-në në disa kategori, siç janë:

1. pagat e stafit (një numër i stafit është paguar nga Shtylla e BE-së)
2. udhëtimet zyrtare,
3. shpenzimet për celularë,
4. shpenzimet publike dhe komunalit (deri 30 qershor 2006).

Në tabelat më poshtë janë dhënë në mënyrë të hollësishme të dhënat financiare:

Tabela 8.1. Pasqyrë e burimeve financiare dhe shpenzimeve në €.

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI	VITI 2006	
	Buxheti	Aktual
BURIMET E FONDEVE		
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	247,446	201,557
UNMIK (Shtylla e EU-së)	N/A	200,468
Organizatrat donatore		
AER	809,524	809,524
BB	441,369	441,369
Gjithsej nga Organizatat e Donatorëve	1,250,893	1,250,893
GJITHSEJ BURIMET E FONDEVE	1,498,339	1,652,918
SHFRYTËZIMI I FONDEVE		
Shpenzimet e Stafit		
UNMIK (Shtylla e EU-së)	N/A	159,258
Buxheti i Konsoliduar i Kosovës	71,196	65,430
Gjithsej Shpenzimet e Stafit	71,196	224,688
Mallrat dhe Shërbimet		
UNMIK (Shtylla e EU-së)	NA	41,210
Buxheti i konsoliduar i Kosovës	176,250	136,127
Gjithsej Mallrat dhe Shërbime	176,250	177,337
Asistenca Teknike nga Donatorët		
UNMIK (Shtylla e EU)	-	-
AER	809,524	809,524
BB	441,369*	441,369
Gjithsej Asistencë Teknike	1,250,893	1,250,893
GJITHSEJ SHFRYTËZIMI I FONDEVE	1,498,339	1,652,918

*600.000,00 USD janë këmbyer sipas kursit të datës 18 prill 2006

Tabela 8.2. Totali i shpenzimeve të ZRrE-së për vitin 2006:

Emërtimi i ndarjeve buxhetore	Shuma	Përqindja nga totali i shpenzimeve
Shpenzimet e stafit	224,688	13.6 %
Mallrat dhe Shërbimet	177,337	10.7 %
Asistenca teknike	1,250,893	75.7 %
Totali	1,652,918	100 %

8.2 Stafi i ZRrE-së

ZRRE-ja në fundit të vitit 2006 ka pasur 25 anëtar të stafit: 15 të financuar nga BKK-ja, 10 të financuar nga buxheti i Shtyllës së BE-së nga të cilët 2 janë ndërkombëtar e 8 vendor. Gjatë vitit 2006 dhe në veçanti gjatë muajve të fundit të këtij viti ka qenë evidente lëvizja e stafit për shkak të pagave të ulëta nga BKK. Gjatë kësaj periudhe 4 punonjës të ZRRE-së të paguar nga BKK-ja dhanë dorëheqje nga pozitat e tyre.

Duke iu referuar funksionimit dhe efikasitetit të stafit, ZRRE-ja gjatë vitit 2006 ka qenë plotësisht funksionale. Sa i përket procedurave financiare të BKK-së, të gjithë pjesëmarrësit udhëheqës kanë qenë vendor, përveç zyrtarit autorizues i cili ka qenë ndërkombëtar (Kryesuesi i ZRrE-së).

8.3 Të hyrat nga taksat e licencave

Zyra e Rregullatorit për Energji ka filluar procedurën për lëshimin e licencave në muajin gusht 2006 ndërsa licencat e para janë lëshuar në tetor 2006. Sipas Ligjit 2004/09 dhe vendimit të bordit të ZRRE-së, është vendosur vjelja e një takse fillestare dhe vjetore nga të licencuarit. ZRRE-ja në emër të taksave fillestare ka mbledhur 67.170,00 euro. Ndërsa në emër të tarifave vjetore të të licencuarve për periudhën tetor-dhjetor 2006 janë mbledhur 67.446,54 euro. Shuma totale e mbledhur në emër të tarifave gjatë periudhës tetor-dhjetor 2006 është 134.546,54 euro.

Një pjesë tjetër e obligimeve të të licencuarve për vitin 2006 do të mbledhen në vitin 2007. Nëse Zyra e Rregullatorit të Energjisë i mbledh të gjitha tarifat e projektuara të licencave atëherë ZRRE-ja mund të funksionoj dhe të realizoj nivelin e pagave të paraparë në Planin e Biznesit dhe të mbajë staf të mirë ekspertësh.

8.4 Plani i biznesit

Më 16 janar 2006, Bordi i ZRRE-së miratoi Planin e biznesit për një periudhë pesëvjeçare (2005-2009), në të cilin janë shprehur qëllimet, strategjia dhe iniciativat e ZRRE-së gjatë kësaj periudhe financiare. Ky plan në mënyrë të veçantë paraqet kornizën e misionit të ZRRE-së, mandatin, objektivat dhe organizimin e saj; ofron një pamje të strukturës dhe perspektives zhvillimore në Sektorin e energjisë në Kosovë; identifikon sfidat me të cilat ballafaqohet ZRRE-ja në kuptim të qëllimeve strategjike dhe faktorëve të cilët mund të kenë ndikim në arritjen e tyre; specifikon projektet, rezultatet dhe kohëzgjatjen e tyre gjatë vitit 2006 dhe përcakton strategjitë dhe iniciativat për katër vitet e ardhshme financiare; definojnë burimet e nevojshme për implementimin e projekteve dhe iniciativave të planifikuara; dhe përmban projeksione të hollësishme financiare për periudhën katër vjeçare që kanë qenë subjekt i planit. Plani i biznesit është publikuar në uebfaqen e ZRrE-së.